

**PSP konfirmon**

Montuesit e "Sopotit" do të shpëtojnë!

Fq.5



**KËSHILLI PËR ETIKË**

Mediat onlajn, të parët për shpifje

Fq.7



**Adelinë, ç'të panë sytë!**

Fq.10

**Forum**



www.koha.mk **Koha**



**Ismaili, më i mirë i turnirit**

Fq.19

**EDITORIAL**

**Shqiptarët po i vret (pa)drejtësia!**



Gjashtë inspektorë të DSK-së tash së fundmi kanë pranuar përfshirjen e tyre në inskenimin e hedhjes në erë të një xhipi ushtarak, në afërsi të fshatit Sopot të Kumanovës, në vitin 2003, me ç'rast jetën e patën humbur dy ushtarë polakë të NATO-s dhe një përkthyes maqedonas. Mediat që kishin hulumtuar këtë ngjarje monstruoze, prej fillimit kanë dyshuar se bëhet fjalë për një montim klasik nga ana e strukturave të caktuara të sigurisë me qëllim që faji t'iu vishet 10 fshatarëve të Sopotit, duke i dënua me 140 vite burg. Nga dëshmitë e reja të këtyre inspektorëve... Fq.2

**GLOBI**

**Masakër në Guta, Asadi tallet me botën**

Fq.17

**RAJON**

**Kosovë, 10 mijë lindje më pak për 7 vite**

Fq.16



**EKSPERTËT KRITIK PËR KTHIMIN E PËRBËRJES SË VJETËR**

**HAPA MBRAPA PËR KSHZ-në**



"Tash për tash do të kemi kthim të përbërjes së vjetër, siç u dakorduan kryeministri Zaev me kryetarin VMRO-së me shtatë anëtarë - tre nga opozita dhe katër nga partitë në pushtet, por nëse është e përkohshme kjo zgjidhje apo e përhershme, mbetet të shihet si do të vendosin më tej partitë politike parlamentare", tha për gazetën KOHA, zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski Fq.3

**63 milionë kushton autostrada Shkup-Bllacë**

Shkup, 5 mars - Për momentin jemi duke punuar dhe jemi shumë afër përfundimit të projektit të ri për ndërtimin e rrugës Shkup-Bllacë, ndërsa me rishikimin e Buxhetit për vitin 2018, do të parashihet shuma e saktë e parave buxhetore që do shkojnë për fillimin e ndërtimit të këtij aksi rrugor që lidh Maqedoninë me Kosovën. Kështu ka thënë ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, sipas të cilit, në fillim të vitit 2019, ekziston mundësia që autostrada të fillohet të ndërtohet. "Drejtoria për Rrugë Shtetërore po ashtu do të fillojë me shtimin e këtij aksi rrugor për të cilën shteti me Buxhetin e vitit 2018 ka ndarë 3 milionë euro për riparimin e rrugës Shkup-Bllacë", ka thënë Bekteshi. Për këtë rrugë të hënën ka folur edhe zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev, i cili ka...

fillim të vitit 2019, ekziston mundësia që autostrada të fillohet të ndërtohet. "Drejtoria për Rrugë Shtetërore po ashtu do të fillojë me shtimin e këtij aksi rrugor për të cilën shteti me Buxhetin e vitit 2018 ka ndarë 3 milionë euro për riparimin e rrugës Shkup-Bllacë", ka thënë Bekteshi. Për këtë rrugë të hënën ka folur edhe zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev, i cili ka... Fq.6



## EDITORIAL

SHQIPTARËT PO  
I VRET (PA)DREJTËSIA!

Emin AZEMI

Gjashtë inspektorë të DSK-së tash së fundmi kanë pranuar përfshirjen e tyre në inskenimin e hedhjes në erë të një xhipi ushtarak, në afërsi të fshatit Sopot të Kumanovës, në vitin 2003, me ç'rast jetën e patën humbur dy ushtarë polakë të NATO-s dhe një përkthyes maqedonas. Mediat që kishin hulumtuar këtë ngjarje monstruoze, prej fillimit kanë dyshuar se bëhet fjalë për një montim klasik nga ana e strukturave të caktuara të sigurisë me qëllim që faji t'iu vishet 10 fshatarëve të Sopotit, duke i dënuar me 140 vite burg. Nga dëshmitë e reja të këtyre inspektorëve zbulohet se ata me shumë zell kishin punuar që kësaj vrasjeje, të cilin e kishin kurdur ata vetë, t'i japin dimensione imagjinative, duke detyruar madje njërin prej të akuzuarve, Ramadan Bajramin, të deponojë deklaratë të rrejshme në rrethana të presionit fizik. Tash, kur gjithçka u zbulua, drejtësia vazhdon inercionin e vet, duke rikthyer procesin e "Sopotit" prej fillimit, me një epilog të gjymtuar që do të shpallte eventualisht pafajësinë e 10 sopotasve, pas 5-60 viteve të kaluar nëpër burgje. Por, siç ndodhë zakonisht me proceset kur janë në pyetje shqiptarët, drejtësia edhe kësaj radhe nuk do ta sqarojë deri në fund këtë ngjarje makabre. Ngjashëm si në rastin "Monstra", ku tjetër kush i kishte vra pesë maqedonasit të Liqeni i Smilkovës, por ata ende nuk po dalin para drejtësisë, edhe në rastin "Sopot" gjashtë inspektorët e DSK do të shëtitën të lirë, sepse ata mund të kenë nevojë ta përsëritin veprën penale dhe mundësisht - të inskenojnë edhe ndonjë ngjarje që do të merrte jetë njerëzish.

Me këtë sistem drejtësie që aktualisht ka mbërthyer Maqedoninë, mund të presim që edhe në të ardhmen veprat penale t'i bëjnë maqedonasit, kurse vuajtjet e dënimit t'i mbajnë shqiptarët. Vetëm në një shtet si ky që ende ruan recidiva totalitariste në sistemin gjyqësor, qytetarët të mos e ndiejnë veten mirë, sepse ka plotë prokurorë e gjyqtarë që janë të predispozuar të ndajnë drejtësi, jo mbi kritere profesionale, por mbi përkatësinë etnike të të akuzuarve, duke rezervuar për shqiptarët dënime special dhe drakonike.

Nëse i bëjmë një inspektim gjithë burgjeve të Maqedonisë dhe nëse zhvillojmë një anketë me të burgosurit, do të rezultojë se sistemi gjyqësor këtu te ne është një gijotinë e pamëshirshme që ka prodhuar vuajtje të panumërta njerëzore, që në të shumtën e rasteve janë vendime të padrejta, tendencioze, të njëanshme, me epilog frapant për shumë fate shqiptarësh, jeta e të cilëve padrejtësisht është mbyllur brenda mureve të lagshta të burgjeve të Maqedonisë.

Gjashtë inspektorë të DSK-së që pranuan se kanë kurdur vrasjen e tre vetave në afërsi të Sopotit, nuk do të jenë objekt i asnjë gjykate në Maqedoni. Me këtë mosveprim institucional ndaj tyre, Maqedonia dërgon këtë mesazh në botë: këtu zyrtarët shtetërorë mund të përsërisin edhe në të ardhmen krime, mjafton të plotësohen dy kushte: që ata të jenë maqedonas, kurse si eksperiment i këtyre inskenimeve mund të jenë sërish shqiptarët, si mall i lirë dhe pa vlerë.

Po si ndodhi që krejt këto inskenime e dënime të pafajshme të kalojnë pa u regjistruar në ndërgjegjen e ndonjë ministri shqiptar të Drejtësisë? Si ka qenë e mundur që edhe përkundër gjithë këtyre padrejtësive, të mos japë dorëheqje as një ministër shqiptar i Drejtësisë, si shenjë përgjegjësie morale e politike për këto standarde të çuditshme të organeve të drejtësisë? Në Maqedoni nuk ka patur dhe ende nuk ka gjyqësi të pavarur, ndaj tingëllojnë absurde arsyetimet e ndonjë funksionari shqiptar se nuk duan të ndërhyjnë në pavarësinë e gjyqësorit. Në fakt, mosdërhyrja e tyre ua ka dhënë argumente shitesë gjykatësve të ngarkuar me acionalkizëm, që të jenë edhe më të njëanshëm ndaj shqiptarëve. Ky është mjerim, në të cilin, me neglizhencën dhe mosveprimin e tyre, kanë kontribuar edhe vetë faktorët politikë shqiptarë, kush më shumë e kush më pak.

"Monstra", "Sopot", "Alfa"... janë radiografia e tmerrshme e një kronike të dhimbshme që vazhdon të kullojë gjak e lot mbi kurrrizin e shqiptarëve të pafajshëm dhe të pambrojtur!

NUK DO TË LEJOJ ASKËND TË VË VETO PËR  
FORMIMIN E USHTRISË

"Niveli i përgatitjes suaj në shumë dimensione, është më i mirë se i forcave të armatosura të rajonit. Edhe pse sot është një ditë festive ku përkujtohet krenaria dhe sakrifica për liri dhe pavarësi, nuk mund të mos e themi se marshin tuaj të ecjes përpara në transformimin profesional, nuk arriti ta përcillte politika jonë. Jam i bindur se ky hap i final i bërjes së Kosovës me Forcë të Armatosura, pas një periudhe të gjatë të zhvillimit të Forcave të Sigurisë, në një partneritet të shkëlqyeshëm me SHBA-në, KFOR-in dhe NATO-në, është në interes të gjithë qytetarëve të Kosovës, të të gjitha komuniteteve, të sigurisë dhe paqes në Kosovë dhe rajon. Ne duam dhe synojmë që Forcat e Armatosura të bëhen me ndryshime Kushtetuese, duke u bashkuar në një vend në Kuvendin e Kosovës, vullnetin politik, të të gjitha komuniteteve, por në të njëjtën kohë nuk do të lejojë askënd të vë veto të pakufishme për të drejtën tonë legjitime dhe legale", ka shkruar në profilin e tij zyrtar në FB, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

## SHUMË AFËR RATIFIKIMIT TË DEMARKACIONIT

"Puna e madhe rreth kushteve të partive e ka sjellë Marrëveshjen për Demarkacionin me Malin e Zi më afër se kurrë për t'u ratifikuar. Deputetë, është koha që t'i afroheni vijës së fundit këtë javë", ka shkruar ambasadori i SHBA-së në Kosovë, Greg Delavie, në llogarinë e tij në Twitter. Ndryshe, Parlamenti kosovar edhe pas tentimit të tretë që u mbajt javën e kaluar më 28 shkurt, nuk arriti ta ratifikojë Marrëveshjen për demarkacion të kufirit me Malin e Zi.

Shefat e Grupeve Parlamentare janë pajtuar me konsensus të plotë që seanca për votimin e Demarkacionit të shtyhet për javën e ardhshme, për t'i dhënë hapësirë edhe pak ditë reflektimit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Listës Serbe.

SHQIPËRIA, VENDI I VOGËL MUSLIMAN QË  
SHPËTOI GJYSHËRIT TANË NGA HOLOKAUSTI

"Traditat e forta kombëtare frymëzuan shqiptarët që të shpëtojnë jetët e hebrenjve gjatë Holokaustit. Shqipëria, vendi i vetëm europian me shumicë muslimane, ishte njëkohësisht edhe i vetmi vend europian që doli nga Holokausti me një popullsi më të madhe hebreje se sa më parë. "Yad Vashem", Qendra Përkujtimore e Holokaustit në Izrael ka njohur 75 shqiptarë që kanë luajtur një rol vendimtar në shpëtimin e hebrenjve. Duke pasur parasysh territorin e vogël dhe komunitetin e vogël hebre që përpara Luftës numëronte vetëm 200 vetë, ky është një numër jashtëzakonisht i lartë. Një hebre në Shqipëri, gjatë Luftës së Dytë Botërore, kishte dhjetë herë më shumë shanse për t'u shpëtuar se sa një bashkëkombas i tij në qendrat e mëdha të hebrenjve në Lituani apo Poloni. Shqiptarët shpëtuan gjithashtu qindra refugjatë hebrej që iu larguan Holokaustit nga Gjermania, Austria, Greqia apo vende të tjera", shkruan në profilin e saj zyrtar në FB, Qendra e Studimeve të Holokaustit në Izrael "Yad Vashem".

## Çfarë ishte Kongresi i Durrësit?

Kongresi i Durrësit ishte mbledhje e përfaqësuesve të Shqipërisë e mbajtur në Durrës, për të siguruar pas mbarimit të Luftës I Botërore pavarësinë, tërësinë territoriale dhe vazhdimësinë e shtetit kombëtar shqiptar. Kongresi i zhvilloi punimet më 25-27 dhjetor 1918 dhe në të morën pjesë mbi 50 delegatë. U zgjodh një qeveri e përkohshme e përbërë nga 14 anëtarë. Kongresi vendosi të formohej edhe një Pleqësi (senat), si organ këshillues i qeverisë. Delegatët e mbledhur në Kongresin e Durrësit u shprehën për ruajtjen e pavarësisë e të tërësisë territoriale të shtetit

## MEDIACitate

"Ka pasur ide të ndryshme për ndarje dhe ndërrim terrioresh, mirëpo këto janë teza të dëmshme me pasoja të papërbalueshme. Këto ide vijnë nga politikanë autoritarë në Serbi të cilët mendojnë që territori është pronë private e sundimtarëve e jo toka e qytetarëve të shtetit. Politikanët autoritarë nuk e pranojnë Republikën, sepse së pari s'e kuptojnë atë. Ata janë tregtarë mallrash. Për ta gjithçka është mall vlera e të cilit është e llogaritshme. Na kujtohet se si Millosheviqi e Tugjmani kanë tregtuar. Dhe në fund më shumë se ndarjen dhe ndërrimin e terrioreve fitojmë ndarjen dhe përzënie e njerëzve e të popullatës. Të flasësh për ndarje dhe ndërrim terrioresh do të thotë të përgatitesh për luftë të re. Të drejtat qytetare të barabarta dhe reciprociteti në të drejtat kombëtare, së bashku me zhvillimin ekonomik të fokusuar në punësim, sidomos të rinjve dhe grave, është rruga që do të na nxjerrë nga kriza dhe do ta mundësojë përparimin".

(Pjesë nga intervista e Albin Kurtit dhënë në gazetën "Danas" të Beogradit)

Forcat e Armatosura të Turqisë (TSK) që nga fillimi i operacionit që ky vend e ka koduar "Dega e Ullirit", një simbol për paqen, në rajonin kufitar sirian Afrin kanë vrarë 2777 kurdë, të cilët regjimi në Turqi i cilëson terroristë. Në një deklaratë, që e transmeton Anadolu Agency, nga Shtabi i Përgjithshëm i Turqisë thuhet se vazhdojnë operacionet ajrore dhe tokësore për, siç shprehen ata, neutralizimin e terroristëve, anëtarë të organizatave terroriste PKK/KCK/PYD-YPG dhe DEASH. Operacioni i forcave turke "Dega e Ullirit", në Afrin të Sirisë ka filluar më 20 janar të vitit 2018, dhe me arsyetim për të vendosur siguri dhe stabilitet përgjatë kufijve të Turqisë dhe rajonit si dhe "për të mbrojtur sirianët nga shtypja dhe mizoria e terroristëve".

(Anadolu Agency, 5 mars)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...



shqiptar, për rishikimin e kufijve të 1913-ës në favor të tij dhe për t'ia paraqitur këto kërkesa Konferencës së Paqes.

OPOZITA SHQIPTARE DHE EKSPERTËT KRITIK PËR KTHIMIN E PËRBËRJES SË VJETËR

# HAPA MBRAPA PËR KSHZ-në

“Tash për tash do të kemi kthim të përbërjes së vjetër, siç u dakorduan kryeministri Zaev me kryetarin VMRO-së me shtatë anëtarë - tre nga opozita dhe katër nga partitë në pushtet, por nëse është e përkohshme kjo zgjidhje apo e përhershme, mbetet të shihet si do të vendosin më tej partitë politike parlamentare”, tha për gazetën KOHA, zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 5 shkurt - Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), njëra ndër institucionet e pavarura më të përfolura për politizimin saj, së fundmi përsëri bie pre e apetiteve politik të dy partive më të mëdha në vend - LSDM-së në pushtet dhe VMRO-së në opozitë. Gjatë takimit të fundit, kokë më kokë midis liderëve të këtyre partive, Zoran Zaev dhe Hristijan Mickoski, mes temave tjera është rënë dakord që KSHZ të kthehet në përfaqësim politik me ç'rast hiqen ekspertët, ide kjo që pritet të formalizohet në ndryshime ligjore. Se do të kthehet përfaqësimi vjetër në KSHZ, do të thotë siç ka qenë më herët me shtatë anëtarë - katër nga pushteti dhe tre opozita, e konfirmon edhe zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski. “Tash për tash do të kemi kthim të përbërjes së vjetër, siç u dakorduan kryeministri Zaev me kryetarin VMRO-së me shtatë anëtarë - tre nga opozita dhe katër nga partitë në pushtet, por nëse është e përkohshme kjo zgjidhje apo e përhershme, mbetet të shihet si do të vendosin më tej partitë politike parlamentare”, tha për gazetën KOHA, Boshnjakovski. Ai tha se nuk është në dijeni që më herët në Grupet e punës për kthimin e opozitës në Parlament mes LSDM-se dhe VMRO-së, është folur që përbërja e KSHZ-së të jetë nga gjykatësit edhe atë nga Gjykata Supreme dhe ajo administrative.

## MARRËVESHJE PA SHQIPTARËT

Lidhur me këtë nuk janë dakord as ekspertët dhe as partitë opozitare shqiptare, ndërsa nga BDI nuk ka ende ndonjë qëndrim konkret. Eksperti Robert Nesimi, që njihet në opinion për analiza të qëndrueshme zgjedhore, thotë për gazetën KOHA se dy partitë më të mëdha në vend, në vend se të



bëjnë hapa përpara, siç shprehet ai për një reformë të gjerë zgjedhore, ata bëjnë hapa prapa duke mos hequr dorë nga përfaqësimi partiak. “Për mua, është tepër zhgënjyese që dy partitë e mëdha - VMRO dhe LSDM të vendosin pa një debat të gjerë në publik dhe pa u pyetur partitë tjera politike. Këta, në vend se të bëjnë hapa përpara pas gjithë atyre përfoljeve dhe kritikave rreth politizimit të KSHZ-së, bëjnë të kundërtën - kthehen në pikën zero ku kanë qenë duke mos hequr dorë nga përfaqësimi partiak”, thotë Nesimi. Në lidhje me heqjen e ekspertëve, për Nesimin nuk është negative, ngaqë sipas tij, ekspertët kishin dëshmuar se ishin të varur nga politika. “Negative për mua nuk është heqja e mundshme e ekspertëve meqë edhe ashtu, ata ishin të varur nga politika, pra nuk ishin ekspertë të pavarur dhe që u dëshmuar për ndonjë gjë”, thotë Nesimi. Sipas tij, zot të besohet se përfaqësimi politik nënkupton të mos zgjidhen ushtarë partiak, si dhe përfaqësimi të mos bazohet në mandate, por në vota përfshirë edhe ato të zgjedhjeve lokale. “Nëse shkohet deri në fund me këtë ide, kisha propozuar që së pari të kihet kujdes se kush po delegohet nga partitë, të mos ndodhë të kemi përsëri ushtarë partiak, pavarësisht profesionit, por persona nga jashtë që do të ishin të pranueshëm për një parti politike. E dyta, përbërja të bazohet jo tek mandatet që ka shumica, por tek votat popullore si ato të

zgjedhjeve parlamentare, ashtu dhe atyre lokale, sepse edhe këto të dyta janë barometër për rritjen ose uljen e një partie politike në elektorat”, thotë Nesimi.

## OPOZITA SHQIPTARE KUNDËR

Nga partitë politike gjithashtu janë kritik ndaj qasjes së VMRO-së dhe LSDM-së, ndërsa kërkohet një debat gjithëpërfshirës për kompletimin e KSHZ-së. “Aleanca për Shqiptarët përkrah çdo nismë dhe iniciativë për dialog të brendshëm politik mes forcave politike për të gjetur mundësi dhe qëndrime të përbashkëta progresive për integrimin e vendit në BE dhe NATO. Ndërsa sa i përket asaj që u bisedua në media, se dy liderët Zaev dhe Mickovski kanë biseduar për formatin e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, pa qenë prezent përfaqësues të forcave politike shqiptare, për ASH-në çdo epilog do të ishte i papranueshëm pa mbështetjen e subjekteve politike shqiptare”, thotë Flakron Bexheti nga Aleanca për Shqiptarët. Sipas tij, kur bisedohet për KSHZ-në, duhet një format më i gjerë liderësh politik. Për ASH-në duhet dhënë mundësia e ekspertëve të pavarur që ta reformojë KSHZ-në dhe ta pastrojë Listën zgjedhore. “Çështje të kësaj natyre ku bën pjesë edhe KSHZ, duhet biseduar në një format më të gjerë liderësh të partive politike, në kuadër të një konsensusi më të gjerë politik. Vlerësojmë se KSHZ duhet të jetë një organ i pavarur poli-

tikisht, duke ju dhënë ekspertëve mundësinë për ta reformuar atë institucion nga ndikimi politik, për ta pastruar Listën zgjedhore, dhe për ta bërë të besueshëm për të gjithë qytetarët e Maqedonisë”, tha Bexheti.

Abdush Imeri, zëdhënësi i Lëvizjes BESA me kryetar Bilall Kasami, thotë se mendësia e ekskluzivitetit të partitë maqedonase po vazhdon ende. Ai pret një debat gjithëpërfshirës për të nxjerr modelin që i duhet KSHZ-së. “Edhe një nga tentimet që partitë maqedonase të vendosin për çështjet që i tangojnë gjithë qytetarët, mendësia e ekskluzivitetit po vazhdon. Presim debat gjithëpërfshirës për të treguar vlerësimet tona rreth modelit se si duhet të duket KSHZ, dhe nuk mund të pranojmë zgjidhje, të cilët na ofrojnë partitë maqedonase siç kanë vepruar edhe në të kaluarën, duke i sjell partitë shqiptare dhe tjera jo maqedonase para aktit të kryer”, thotë Imeri.

Ai kërkon që katër partitë më të mëdha parlamentare të bisedojnë sipas traditës për të sjellë modelin që reflekton realitetin politik në shtet. “Kërkojmë që të vazhdoj tradita e deritanishme që katër partitë më të mëdha nga zgjedhjet e fundit parlamentare, të ulen dhe të sjellin modelin më të mirë që do ta reflektoj realitetin politik dhe shoqëror të shtetit. Presim debat gjithëpërfshirës për të treguar vlerësimet tona rreth modelit se si duhet të duket KSHZ, dhe nuk mund të pranojmë zgjidhje të cilët na ofrojnë partitë maqedonase siç kanë vepruar edhe në të kaluarën, duke i sjell partitë shqiptare dhe tjera jo maqedonase para aktit të kryer”, thotë Imeri nga Lëvizja BESA.

Ndryshe, Zaevi dhe Mickoski kanë biseduar edhe për legjislativën zgjedhore me ç'rast është dakorduar që të harmonizohet deri në shtator. Siç ka thënë Zaev, në këto korniza është dakorduar që KSHZ të jetë organ administrativ, ndërsa partitë politike gjashtë muaj para zgjedhjeve do të marrin pjesë në KSHZ. Qëllimi është, siç theksoi kryeministri, të vendoset një zgjidhje e përhershme, e cila nuk do të shkaktojë ndikim negativ ndaj proceseve politike. “Deri atëherë, u dakorduam që pasi Maqedonia duhet të ketë KSHZ, pasi për momentin nuk ka, ta kthejmë vendimin e vjetër ligjor ku kryetarin e propozon opozita, ndërsa shumicën në KSHZ e ka shumica parlamentare”, sqaroi Zaevi. Por, për KSHZ-në është folur edhe në Grupet e punës mes LSDM-së dhe VMRO-së që përbërja e saj të jetë me short nga Gjykatësit e Gjykatës Supreme dhe ajo Administrative dhe të hiqet përfaqësimi nga partitë politike. Por duket që kërkesa ka ardhur prej VMRO-së dhe është pranuar nga ana e kryeministrit Zaev.

ROBERT NESIMI

Për mua, është tepër zhgënjyese që dy partitë e mëdha - VMRO dhe LSDM të vendosin pa një debat të gjerë në publik dhe pa u pyetur partitë tjera politike. Këta, në vend se të bëjnë hapa përpara pas gjithë atyre përfoljeve dhe kritikave rreth politizimit të KSHZ-së, bëjnë të kundërtën - kthehen në pikën zero ku kanë qenë duke mos hequr dorë nga përfaqësimi partiak

FLAKRON BEXHETI

Çështje të kësaj natyre ku bën pjesë edhe KSHZ, duhet biseduar në një format më të gjerë liderësh të partive politike, në kuadër të një konsensusi më të gjerë politik. Vlerësojmë se KSHZ duhet të jetë një organ i pavarur politikisht, duke ju dhënë ekspertëve mundësinë për ta reformuar atë institucion nga ndikimi politik, për ta pastruar Listën zgjedhore, dhe për ta bërë të besueshëm për të gjithë qytetarët e Maqedonisë

ABDUSH YMERI

Presim debat gjithëpërfshirës për të treguar vlerësimet tona rreth modelit se si duhet të duket KSHZ, dhe nuk mund të pranojmë zgjidhje të cilët na ofrojnë partitë maqedonase siç kanë vepruar edhe në të kaluarën, duke i sjell partitë shqiptare dhe tjera jo maqedonase para aktit të kryer

## RAUNDI RI I NEGOCIATAVE PËR EMRIN Koxias në Shkup pas 15 marsit

Shkup, 5 mars - Në gjysmën e dytë të marsit, shefi i diplomacisë greke Nikos Koxias duhet të mbërrijë për vizitë në Shkup në takim me ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, ndërsa raundi i ri për procesin e negociatave nën udhëheqësi të ndërmjetësuesit Methju Nimic pritet të caktohet në fund të marsit ose fillim të prillit, paralajmëroi kryeministri Zoran Zaev. "Kemi paralajmërim se Koxias do të mbërrijë në javën e tretë ose të katërt të marsit, dhe me ardhjen e tij në aeroportin e Shkupit do të mund të bëhen tentime për afrim të qëndrimeve, ndërsa procesi i negociatave do të vazhdojë nën udhëheqësinë e ndërmjetësuesit Nimic", tha Zaev pas takimit të mbrëmshëm me liderin e VMRO-DPMNE-së opozitare Hristijan Mickoski. Kryeministri Zaev pret që Koxias në Shkup ta prezantojë projekt-versionin grek për zgjidhjen e kontestit për emrin. "E presim draft versionin e parë të vijë me ministrin Koxias, ashtu është dakorduar. Le të vijë, kemi të drejtë për komentet tona ose çfarëdo qoftë. Kjo mund të ndihmojë, por mundet që aspak edhe të mos shqyrtohet, mund të mos jetë edhe lëndë e bisedimeve. Megjithatë, nuk është i kotë çdo zhvillim i ideve të cilat do të ndodhnin, ndërsa do të ishin ndihmë që të shqyrtohen nga cilado palë nëse vijën në tryezë", tha Zaev. Ai theksoi se e ka informuar kryetarin e VMRO-DPMNE-së Mickoski për hollësi në pjesën e bisedimeve me Greqinë dhe për qëllimet se si të rrjedhin proceset e negociatave, por edhe që të dyja palët mbeten në pozicionet e tyre.

## DITA E MËSUESIT NË UNIVERSITETIN "NËNË TEREZA" NË SHKUP

"Do të punojmë në mënyrë të veçantë për të dhënë kontributin tonë në fushën akademike, shkëmbimin e përvojës, bashkëpunimin në projekte kërkimore shkencore, duke krijuar pse jo një unison të universiteteve për tu përballur kudo në botë me dijet tona", thotë rektori i universitetit të Tiranës, Mynir Koni

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 5 mars - Shënimi i datave të rëndësishme historike, sikurse është edhe ky i hapjes së shkollës së parë të vashave - 131 vjet më parë në qytetin e Korçës, duhet të shërbejë si moment reflektimi për çfarë kemi arritur deri më sot në sferën arsimit dhe ku dëshirojmë të shkojmë. Ky ishte mesazhi që u dha të hënën në Akademinë solleme që kishte organizuar me rastin e 7 Marsit, Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup. Megjithëse i ri sa i takon viteve të funksionimit, UNT nuk është kursyer të jap kontributin e vet në sensibilizimin e ngjarjeve që kanë nderuar historinë e ndritur të shqiptarëve, sidomos atë pjesë që lidhet me arsimin dhe kulturën tonë kombëtare pavarësisht trojeve ku është zhvilluar ajo. Historia e shkollave dhe arsimit është gjithashtu e pandashme dhe një segment që bashkon kombin, pasi çdo herë në të gjitha etapat e historisë - nuk ka munguar kontributi institucional që kanë dhënë Tirana dhe Prishtina në mbështetje të ilimnizmit të shqiptarëve të Maqedonisë ashtu sikurse nuk kanë munguar personalitetet e ndritura të shqiptarëve të Maqedonisë dhe mbështetja popullore për ngjarje që kanë shënuar historinë.

Në shenjë mirënjohjeje për gjithë kontributin që kanë dhënë

# KONI DHE POLLOZHANI PËR UNIFIKIM VLERASH



mësuesit dhe institucionet shqiptare në përhapjen e arsimit dhe konsolidimit të shkollave dhe universiteteve në Maqedoni, rektori i UNT-së, Aziz Pollozhani, i dorëzoi rektorit të Universitetit të Tiranës, prof.dr.Mynir Konit mirënjohjen që UNT ndan çdo vit me rastin e Ditës së Mësuesit. "Do të punojmë në mënyrë të vazhdueshme për të dhënë kontributin tonë në konsolidimin edhe të këtij universitet të ri sikurse është UNT. Do të punojmë në mënyrë të veçantë për të dhënë kontributin tonë në fushën akademike, shkëmbimin e përvojës, bashkëpunimin në projekte kërkimore shkencore, duke krijuar pse jo një unison të universiteteve për tu përballur kudo në botë me dijet tona", u shpreh rektori Koni. Sfidat që kanë sot institucionet arsimore, sipas rektorit të UNT-së, Aziz Pollozhani, është "përprerja për të qenë pjesë e denjë e tërësisë së përbashkët kombëtare dhe në nivelin e duhur për ndërtimin e brezave të rinj, të cilët duhet të përballen me sfidat

e reja në arsimit dhe shkencës në këtë kohë dinamike të përshtatjes me rrjedhat integruese dhe globalizuese". Zëvendësimin e Arsimin, Arbër Ademi, i pranishëm në këtë Akademi, premtoi se Qeveria e Maqedonisë do të vazhdojë përpjekjet për të avancuar shkollimin në gjuhën shqipe me marrjen të gjitha hapave, vendimeve dhe aktiviteteve konkrete në drejtim të këtij synimi. "Sot, të gjithë e dimë se shkollimi në gjuhën shqipe ka qasje në të gjitha nivelet e arsimit në Maqedoni, njëllon si edhe në sferën e kërkimeve shkencore. Por sigurisht se nevojitet edhe më tej mbështetje institucionale e cila nuk do të mungojë", u shpreh Ademi. Ai u shpreh optimist se në gjithë këtë proces MASH nuk do të jetë e vetme, pasi kanë sipas tij në krah universitete dhe gjithë komunitetin akademik, mësime dhe pedagogët e të gjitha hallkave të sistemit arsimor.

Historia e arsimit në gjuhën shqipe është e përbashkët dhe ka

në themel ndjenjën e solidaritetit dhe vijmësisë. Kështu, menjëherë pas shkollës së Krocës (1887) Hamdi Ohri, Sait Najdeni e Rexhep Voka hapën shkollën në qytetet e Maqedonisë. E, me përfundimin e Rilindjes Kombëtare dhe hapat e para të formimit të shtetit shqiptarë, anë e kënd qytete shqiptare të Maqedonisë vërshuan mësuesit nga Shqipëria. Me themelimin e Universitetit të Prishtinës, ky institucion u bë çerdhja e përgatitjes së kuadrove nga Maqedonia dhe në periudha të caktuara nuk mungoi as kontributi i Universitetit të Shkupit. Me ardhjen e sistemit pluralist, Tirana u bë sërish qendra për përgatitjen e kuadrove nga Maqedonia deri në themelimin e Universitetit të Tetovës (UT) dhe Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë (UEJL). Ndihma e Shqipërisë dhe Kosovës në konsolidimin sidomos kadrovik të këtyre dy universiteteve nuk mungoi për asnjë çast ashtu siç ndodh edhe tani me themelimin e UNT-së.

## PAVLOPULLOS NUK LËVIZ NGA "VIJAT E KUQE"

# Ndryshimi i Kushtetutës dhe emrit, parakusht për marrëveshje

Athinë, 5 mars - Ndryshimi i Kushtetutës dhe emrit i cili nuk do të rrezatojë irredentizëm, ndërsa do të sigurojë tre garanci: "jo" për ndryshimin e kufijve, "jo" për bashkësitë etnike jashtë kufijve dhe "jo" për gjuhë që insiston në të drejta jashtë kufijve. Kjo, sipas presidentit grek Prokopis Pavlopoulos, janë parakushtet për zgjidhjen e kontestit me ermin dhe arritjes së marrëveshjes mes Athinës dhe Shkupit. "Të drejtë ta ndryshojnë Kushtetutën e tyre, e pastaj, kur të arrijmë çfarëdo marrëveshje, në këtë marrëveshje do të ketë emër i cili nuk do të rrezatojë irreden-

tizëm. Dhe kur themi irredentizëm mendojmë në tre gjëra: nuk mundet në asnjë rast ky emër të nënkuptojë ndryshim të kufijve. E dyta, nuk mundet ky emër të orientojë në përkatësinë etnike jashtë kufijve të IRJM. Dhe e treta, nuk mundet ky emër të dërgojë në gjuhë jashtë kufijve, që do të shkaktoje të drejta pakice dhe në këtë rajon. Këto tre gjëra janë fakt", deklaroi Pavlopoulos, dje nga kumuna greke Pindas-Kolindur, ku u shpall qytetar nderi. Siç njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, Pavlopoulos theksoi se duhet ndryshim i Kushtetutës si parakusht

themelor për zgjidhje, por edhe "për mbrojtjen e vetë kryeministrit të IRJM".

"Nuk mundet që në momentin kur vijnë të dakordohen për kompromis drejt të cilit edhe ata synojnë, të thonë: këtë kompromis do ta bëjmë, por nuk mundemi tani ta ndryshojmë Kushtetutën, do ta ndryshojmë në të ardhmen. A është ky vend demokratik? Kryeministri i këtij vendi nuk kupton çfarë rreziku shkakton vetë kur deklaron se është i gatshëm të nënshkruajë marrëveshje që është në kundërshtim me Kushtetutën? Mund ta imagjinojë ndonjë lider



nga Perëndimi, nga BE-ja, të thotë diçka të tillë?", shton Pavlopoulos. Sipas Presidentit grek, qëndrimi i Greqisë është i qartë dhe është në pajtim me të drejtën

ndërkombëtare dhe evropiane dhe nuk është "Greqia përgjegjëse nëse vetë, me qëndrimin e tyre, e minojnë perspektivën e tyre për në NATO dhe BE".

PËR SHKAK TË VJETËRSISË SË LËNDËS

# MONTUESIT E "SOPOTIT" DO TË SHPËTOJNË!



Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 5 mars - Nëpunësit e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërbulim, të përfshirë në rastin e "Sopotit", nuk do të përgjigjen penalisht për shkeljet ligjore që i kanë bërë në këtë rast. Tejkalimi i kompetencave dhe marrja me dhunë e deklaratës të dëshmitarit të vetëm, Ramadan Bajrami, për shkak të kalimit të afateve ligjore, nuk mund të procedohet më tutje. Ashtu siç ditë më parë theksuan avokatët e të akuzuara në rastin e "Sopotit", se dispozitat ligjore nuk lejojnë iniciimin e procedurave penale kundër pjesëtarëve të policisë sekrete, të njëjtën gjë të hënën e konfirmoi edhe Prokurorja Speciale, Katica Janeva.

"Mendoj se afatet ligjore për iniciimin e procedurave penale kundër nëpunësve të DSK-së në rastin e 'Sopotit' kanë përfunduar. Sa i përket këtij rasti, në seancën e radhës kur pritet të jepet fjalët përfundimtare, ne do të prononcohem në përgjithësi për këtë lëndë", tha Janeva në pyetjen e gazetës KOHA nëse tani, pasi policët sekret pranuan fajin, të njëjtit do të ngarkohen

me padi për montim rasti. Zvarritje 15-vjeçare e rastit të "Sopotit" nëpër korridoret e gjykatave të Maqedonisë, ndonëse përfundimisht do ta dëshmojë pajafësinë e 10 shqiptarëve të akuzuar nga Sopotit, megjithatë përgjegjësia penale ndaj policisë sekrete, për shkak të vjetërsimit të veprave penale që i kanë kryer, nuk do të jetë e mundur të vërtetohet. Gjatë hapjes së projektit të ri të PSP-së të titulluar "Përforcimi i kapaciteteve operative të PSP-së", shefja e prokurorisë special foli edhe për rastin "Monstra". Si shumë herë deri më tani, ajo edhe kësaj radhe nuk shpali ndonjë detaj të panjohur për këtë lëndë, por vetëm shtoi se me publikimin e raportit të punës, më datë 15 mars, zyrtarisht do të dihet e ardhmja e kësaj lëndë. Njëkohësisht, prokurorja Katica Janeva, të hënën u pyet edhe për rastin "Alfa", i cili kohëve të fundit, pas 9 vitesh, përsëri është aktualizuar. Lidhur me videon e publikuar ku shihet sulmi dhe vrasja e pjesëtarëve të njësitit "Alfa" dhe në përgjithësi për rrjedhën e procesit gjyqësor për këtë lëndë, prokurorja Janeva tha se nuk posedon të dhëna. Megjithatë, ajo

Përgjegjësia penale ndaj policëve sekret, për shkak të vjetërsimit të veprës penale, nuk do të jetë e mundur të vërtetohet. Kështu që, Robert Ivanovski, Boban Stojanovski, Ilija Smilevski, Mile Vellkovski, Mile Andonovski dhe Marjan Nikollovski, që të gjithë punonjës të DSK-së, do të shpëtojnë pa një gjemb në këmbë, edhe pse e montuan rastin më të rëndë kundër shqiptarëve që pas 2001-shit

nënvizoi se javën e ardhshme, kur pritet edhe të publikohet raporti i radhës i PSP-së, opinioni do të marrë përgjigje edhe për këtë rast. Ndryshe, të hënën para promovimit të projektit në fjalë, Jenave tha se ky projekt lidhet edhe me procedurën parahetimore për projektin "Shkupi 2014". Hetimet e filluara për këtë projekt që nga ditë e para të PSP-së, siç theksoi Janeva, janë nga fundi dhe gjurmët për paratë e nxjerra jashtë shtetit po hetohen tutje. Përveç hetimeve financiare të drejtuara nga Italia, ku kryesisht u ndërtuan skulpturat e projektit "Shkupi 2014", shefja e PSP-së tha se prokuroria e saj paratë e fituar dhe të nxjerra ilegalisht nga arka e shteti i heton edhe në Çeki, Greqi, Holandë e Britani. Një javë para publikimit të raportit të punës, Katica Janeva, foli edhe për zvarritjen e procedurave gjyqësore pranë Gjykatës Penale të Shkupit. Me këtë rast, ajo potencoi se kësaj radhe problemi nuk qëndron te Gjykata, por te vetë të akuzuarit dhe avokatët e tyre.

VRASJA E ALMIRIT FILLOI NGA E PARA

## Jovevski demanton vetveten!

Shkup, 6 mars - Procesi gjyqësor për vrasjen e Almir Aliut, të hënën ka filluar nga e para. Për të dytën herë me radhë, për shkak të rifillimit të rastit, para Trupit gjyqësor deklarati të tij e ka dhënë Bojan Iliq, vëllai i vrasësit Boban Iliq dhe e dashura e tij, Tanja Dimovska. Të dy këto dëshmitarë, së bashku me vrasësin Boban Iliq, mbremjen tragjike të qershorit të vitit 2016, ka qenë në veturën e tipit "Mercedes". Deklaratat kundërtënëse e kanë shoqëruar rifillimin e lëndës për rastin Almir Aliu. Kësisoj, deklaratat e vëllait dhe të dashurës të të akuzuarit për "vrasje", Boban Iliq, nuk janë përputhur. Përderisa dëshmitari Bojan Iliq deklaroi se Sedat Aliu, ka qenë personi i cili ka hapur derën e veturës "Mercedes" dhe më pas e ka goditur atë, dëshmitarja Tanja Dimovska ka thënë se lloji automatik i veturës nuk e mundëson

që dikush ta hapë derën nga jashtë, nëse paraprakisht e njëjta nuk hapet nga brenda. Ndryshe, kryeprokurori Lubomir Jovevski, duke u përgjigjur në një pyetje të gazetës KOHA, të hënën tha se vendimi për rikualifikim të aktakuzës në rastin e Almir Aliut, nga "vrasje me paramendim" në "aksident me pasojë vdekje" është miratuar në kohë kur me Prokurorinë Publike ka udhëhequr ushtruesja e detyrës, Liljana Spasovska. Sipas tij, vendimi është marrë me shumicë votash të prokurorëve dhe ndaj të njëjtit nuk nevojitet nënshkrimi. Me këtë deklaratë, kryeprokurori Jovevski e ka demantuar vetveten, pasi ditë më parë - para deputetëve në Parlament, tha se vendimi për rikualifikim të veprës penale "vrasje" në një vepër për kundërvajtje, në rastin e Almir Aliut, është marrë në kohën e Marko Zvërlevskit. Rikualifikimi i kësaj



vepre, ndonëse ende nuk është bërë publike, sipas organizatorëve të protestës qytetare të mbajtur ditë më parë para Prokurorisë Publike në Shkup, ka për qëllim që prokurorja e rastit Suzana Kusigerska, para përfundimit të këtij procesi gjyqësor, të dorëzojë vendimin e miratuar dhe i njëjti të gjykohej për aksident trafiku dhe jo për vrasje me paramendim. (O.Xh)

## KRONIKË

### Sulmohet 48 vjeçari në Gostivar

48-vjeçari nga Gostivari me initiale A.Z të dielën ka denoncuar se rreth orës 16.40 minuta në bulevardin "Vëllezërit Gjinoski", në Gostivar, është takuar me 24-vjeçarin me initiale L.J, gjithashtu nga Gostivari, i cili fillimisht e ka ofenduar dhe kërcënuar, ndërsa më pas edhe fizikisht e ka sulmuar. Në këtë sulm, L.J disa herë e ka goditur me grushte dhe shkelma nga të cilat për pasojë - A.Z ka rënë për toke. Kanë ndërhyrë disa kalimtarë të rastit, të cilët e kanë ndaluar L.J. Sulmuesi L.J menjëherë është arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor të Gostivarit për zbardhjen e plotë të rastit, pas çka do të pasojë edhe padi adekuate.

### Tetovares i keqpërdoret Facebooku

44-vjeçarja tetovare me initiale G.J.R të dielën ka denoncuar keqpërdorim të të dhënave personale nga një person i fshatit Vërbjan i Gostivarit. Një ditë më parë, rreth orës 23.00 ajo ka vërejtur se i dyshuari ka krijuar një profil të rrejshëm në rrjetin social Facebook me emër të saj në të cilin profil ka postuar katër fotografi me disa komente fyese dhe vulgare. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbardhjen e plotë të të gjitha detajeve që ndërlidhen me rastin e denoncuar.

### Raketa për minahedhës gjenden në Haraçinë

Në oborrin e një shtëpie të braktisur në Haraçinë të Shkupit janë gjetur nëntë copa raketa për minahedhës. Rasti është paraqitur në polici, ndërsa ekspertizë ka kryer Sektori për tregti të paligjshme dhe antiterrorizëm. "Më 4 mars të vitit 2018 në orën 13:40 në Njësinë për informacione dhe komandë Shkup, XH.I ka denoncuar se në oborrin e një shtëpie të braktisur në fshatin Haraçinë, të Shkupit, janë gjetur nëntë copë raketa për minahedhës", kumtoi MPB-ja. Siç informojnë prej atje ekspertizë në vendin e ngjarjes kanë kryer ekipe nga Sektori për tregti të paligjshme dhe antiterrorizëm.

### Arrestohen dy kosovarë me pasaporta false

Në aeroportin "Shën Apostull Pali" në Ohër policia arrestoi dy qytetarë të Kosovës të cilët tentuan me pasaporta të dy shtetasve të Maqedonisë ta kalojnë kontrollin kufitar. "Më 4 mars të këtij viti, në orën 18:20, nëpunës policor nga Stacioni policor për vendkalimin kufitar - Aeroporti "Shën Apostull Pali" në Ohër, për shkak të dyshimit për vepër të kryer penale "shërbim me dokument të huaj udhëtimi" i kanë arrestuar personat B.A. (34) dhe E.R. (35), të dy nga Kosova. Ata treguan dokumente udhëtimi të Maqedonisë me të dhëna për personat S.D. (29) nga Krushopeku, komuna e Sarajit dhe R.M. (46) nga Hasanbegu, rajoni i Shkupit", informon MPB. (U.H.)



## Milenkov dha dorëheqje nga Antikorrupsioni

Shkup, 5 mars - Ish kryetari i Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit Goran Milenkov dha dorëheqje, konfirmuan për MIA-n nga Antikorrupsioni. Dorëheqja e re është dorëzuar deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Milenkov dorëheqjen e parashtron pa u bërë një javë pas raportit revizor të publikuar në DAP-i për punën e anëtarëve të KSHPK-së. Në raport janë theksuar dyshime për pagesën e fletdhëtimeve fiktive dhe shpenzimeve të parave të buxhetit. Për raportin e revizorëve për Antikorrupsionin, hetim hapi Prokuroria Publike, ndërsa shumica parlamentare u bëri thirrje anëtarëve t'i japin dorëheqje apo do të inicohet shkarkimi i tyre në Kuvend. Kryetari i Antikorrupsionit, Igor Tanturovski, ndërkaq, mohon se ka paligjshmëri në punën e Komisionit dhe tha se nuk do të japë dorëheqje.

## PROJEKTI I RI PËR NDËRTIMIN E AUTOSTRADËS ËSHTË GATI

# 63 MILIONË KUSHTON

# AUTOSTRADA SHKUP-BLLACË

"Është turp që në shekullin 22, një distancë rrugore prej 90 kilometra ta bëni për dy orë. Turpi më i madh është kur tanimë veç kemi informata të sakta se nga ana kosovare janë gati ta lëshojnë në përdorim autostradën nga Prishtina deri në Han të Elezit...", ka thënë Angjushev

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 5 mars - Për momentin jemi duke punuar dhe jemi shumë afër përfundimit të projektit të ri për ndërtimin e rrugës Shkup-Bllacë, ndërsa me rishikimin e Buxhetit për vitin 2018, do të parashihet shuma e saktë e parave buxhetore që do shkojnë për fillimin e ndërtimit të këtij aksi rrugor që lidh Maqedoninë me Kosovën. Kështu ka thënë ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, sipas të cilit, në fillim të vitit 2019, ekziston mundësia që autostrada të fillohet të ndërtohet.

"Drejtoria për Rrugë Shtetërore po ashtu do të fillojë me sanimin e këtij aksi rrugor për të cilën shteti me Buxhetin e vitit 2018 ka ndarë 3



milionë euro për riparimin e rrugës Shkup-Bllacë", ka thënë Bekteshi. Për këtë rrugë të hënën ka folur edhe zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev, i cili ka informuar se projekti për ndërtimin e autostradës Shkup-Bllacë në distancë prej 13 kilometrave është gati dhe se e njëjta pritet të kushtojë 63 milionë euro. "Ky projekt është shumë i rëndësishëm dhe jorastësisht është i vendosur si prioritet numër një i Qeverisë ak-

tuale. Kemi biseduar edhe me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe i njëjti të financohet në vlerë prej 63 milionë euro sa është vlerësimi parë i financave të nevojshme për të filluar me ndërtimin e këtij aksi rrugor", thotë Angjushev. Ndërtimi i kësaj autostrade me mjete buxhetore, sipas Angjushev, në radhë të parë është me interes të veçantë për Maqedoninë, sepse siç është shprehur ai, Kosova është partneri më i madh i

Maqedonisë sa i përket këmbimit tregtar. "Është turp që në shekullin 22, një distancë rrugore prej 90 kilometra ta bëni për dy orë. Turpi më i madh është kur tanimë veç kemi informata të sakta se nga ana kosovare janë gati ta lëshojnë në përdorim autostradën nga Prishtina deri në Han të Elezit, gjegjësisht deri në vendkalimin Bllacë që lidh Kosovën me Maqedoninë, ndërsa Maqedonia vetëmse duhej ta kishite përfunduar këtë autostradë shumë vite më parë se Kosova, por për shkak se Qeveria e mëparshme nuk ka pasur projekt final, por vetëm dokumentacionin teknik - kjo nuk është bërë. Tani ne kemi projektin final dhe pasi ta kalon revizionin, paratë për ndërtimin e kësaj rruge në gjatësi prej 13 kilometrave do të sigurohen nga ana e Qeverisë dhe vitin e ardhshëm - do të fillohet me ndërtimin e autostradës shumë të përforur gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit", tha Angjushev.

## NUK PO PËRGATITET RIBALANC I BUXHETIT

Kthimi i TVSH-së ndaj kompanive është rritur, kryhet në mënyrë joselektuese dhe shpejt, ndërsa nuk po përgatitet ribalanci i Buxhetit, sepse të ardhurat e publikuara për fillimin e vitit janë solide dhe sigurojnë rritje adekuatë, informoi ministri i Financave, Dragan Tevdovski. Të dhënat e Ministrisë së Financave tregojnë se kthimi i TVSH-së në dy muajt e parë të vitit është për 56 për qind më e lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2017, gjegjësisht në janar

dhe në shkurt të këtij viti janë kthyer 1,4 miliardë denarë më shumë në ekonomi. Vitin e kaluar është realizuar kthim i TVSH-së për 2,2 miliardë denarë më shumë në krahasim me vitin 2016, gjegjësisht për 12,2 për qind më shumë. Realizimi i investimeve kapitale në fillim të vitit është më i ulët, por bëhet presioni i fuqishëm deri te të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë që t'i rritin aktivitetet dhe pritet sivjet, në krahasim me vitin e kaluar të ketë realizim të tyre më të lartë.

## "VITI I GJERGJIT", MANIFESTIMI I PARË MBARËSHQIPTAR

# Java e Kulturës, nga Shkupi në diasporë

Koha Evis HALILI

Shkup, 5 mars - Java e kulturës shqiptare është një prej manifestimeve në kuadër të shënimit të "Vitet të Gjergjit" në Maqedoni që do të zhvendoset nga Shkupi në disa qendra në botë ku jetojnë shqiptarët. Prezantime librash, ekspozita me dokumente e materiale historike, dokumentarë, e të tjera janë pjesë e kësaj ngjarje që do të zhvillohet në muajin qershor nën kujdesin e Institutit të Trashëgimisë. Qendrat e kulturës, apo edhe konsullatat e Shqipërisë dhe Kosovës do të jenë disa prej lokacioneve ku do të mbahet java e kulturës, duke e vendosur kështu në agjendën e shënimeve të përbashkëta mbarëshqiptare. Përveç prezantimeve që lidhen me fi-

gurën e heroit kombëtar, në këto aktivitete do të vihen në qendër edhe materiale të tjera që lidhen me personalitete të tjera shqiptare, si Pjetër Bogdani, Jashar Bej Shkupi, familjet katolike në Shkup, e të tjera. Sa i takon aktivitetet të tjera që do të zhvillohen në Maqedoni me rastin e Vitit të Skënderbeut, Këshilli i ngritur nën patronazhin e kreut të kuvendit Talat Xhaferri ka caktuar disa data, të cilat mbyllen më 22 nëntor, në 110 vjetorin e Kongresit të Manastirit. Një pjesë prej tyre financohen nga ministri dhe institucione të tjera shtetërore dhe realizohen nga IT-SHKSH. Pas dy datave të shënuara më 17 janar (550 vjetori i vdekjes së Skënderbeut) dhe 2 mars (574 vjetori i Besëlidhjes Shqiptare të Lezhës) ngjarje të tjera janë kryesi-

sht në muajin qershor, si 140 vjetori i Lidhjes së Prizrenit, 100 vjetori i lindjes së Nexhat Agollit, 140 vjetori i lindjes së Hasan Prishtinës, 90 vjetori i largimit të Nënë Terezës nga Shkupi, e të tjera.

"Java e kulturës shqiptare do të zhvillohet në disa qendra në Evropë dhe SHBA (Nju Jork) në javën e dytë të muajit qershor dhe është ngjarja e parë që zhvillohet në koordinim edhe me Tiranën dhe Prishtinën si pjesë e shënimeve mbarëshqiptare. Disa lokacione dihen, por ende nuk janë konfirmuar të gjitha qendrat ku do të zhvillohen aktivitetet e kësaj jave. Sa i takon aktivitetet brenda Maqedonisë gjatë këtyre muajve do të shënojmë një sërë datash që kanë një rëndësi të posaçme për ne shqiptarët, në bashkëpunim me mi-

nistrinë e Kulturës dhe Arsimit, Sekretariatit për Implementimin e MO, institucione të tjera, e shoqata. Po ashtu aktivitetet do të koordinohen edhe me institucionet e tjera në Tiranë e Prishtinë, si Instituti i Historisë", thotë zëvendëskryetari i Këshillit për shënimin e Vitit të Gjergjit, Skënder Asani.

Si ngjarje më të rëndësishme kulturore me rastin e Vitit të Skënderbeut në Maqedoni priten të jenë edhe premiera e operës "Skënderbeu", si edhe interpretimi i artistit Shkëlzen Doli në Filarmoni. Një javë me manifestime kulturore do të zhvillohet po ashtu edhe Manastir, ndërsa godina e Muzeut të Alfabetit pritet të përfundojë me rikonstruktimin dhe arredimin e kompletimin e ambienteve.

Përveç prezantimeve që lidhen me figurën e heroit kombëtar, në këto aktivitete do të vihen në qendër edhe materiale të tjera që lidhen me personalitete të tjera shqiptare, si Pjetër Bogdani, Jashar Bej Shkupi, familjet katolike në Shkup, e të tjera

RAPORT I KËSHILLIT PËR ETIKË NË MEDIAT NË MAQEDONI

# MEDIAT ONLAJN, TË PARËT PËR SHPIFJE



KEMM u bën thirrje të gjitha mediave të punojnë me integritet profesional dhe të përkushtohen për zbatim të përkushtuar të principeve themelore të gazetarisë etike


Koha

Evis HALILI

Shkup, 5 mars - Treguesit për shifrat dhe llojet e ankesave të dërguara Komisionit për Ankesa pranë Këshillit për Etikë në media në Maqedoni (KEMM) në tre vitet e kaluara (2014-2017), tregojnë se standardet etike dhe profesionale të gazetarisë më së shumti janë thyer prej onlajn mediave (79%), pastaj prej televizioneve (12,6%) dhe prej atyre të shkruara ditore dhe javore (8%). Kështu thuhet në Raportin e fundit të KEEM, sipas të cilës, prej gjithsej 214 ankesave të dërguara në Këshill në periudhë prej tre viteve, numri më i madh janë prej organizatave të sektorit civil (27,5%), pastaj prej mediave dhe gazetareve (25,7%), prej bartësve të funksioneve publike, institucioneve dhe partive politike (23,8%) dhe nga subjekte të tjera (22,9%). Në 175 raste, Komisioni ka vërtetuar thyerje të Kodeksit të gazetareve dhe ka shqiptuar sanksione morale, 28 ankesa janë vendosur si të pa bazë ose jashtë juridiksionit të Komisionit, ndërsa 11 ankesa janë vendosur me anë të mediacionit.

Për KEMM, më së shumti që duket brenguese është fakti se thyerjet më të

mëdha janë ato të rregullave themelore të etikës gazetareske: shpallja e informatave të sakta, të verifikuara, dhe të gjithpërfshirura dhe gjithashtu ndarja e fakteve nga mendimi i gazetarit. "Veçanërisht brengos ajo që 49 ose 28,8% nga numri i përgjithshëm i ankesave janë për media të cilat kanë bërë përhapje të gjuhës së urrëjtjes, kanë përdorur deklarata diskriminuese ose kanë nxitur stereotipa dhe në këtë mënyrë - kanë dëmtuar seriozisht pjesëtarët të grupeve të veçanta. Publiku, i cili kryesisht informohet nga onlajn portalet ose media të tjera, të cilat nuk i respektojnë rregullat të gazetarisë etike, bëhen objekt i lehtë për manipulim, për arsye të numrit të madh të informatave të sajura apo gjysëm të vërteta. Efekti me manipulimin me mendimin publik edhe më shumë rritet me atë që dezinformimet dhe storjet e sajura pastaj ndahen dhe komentohen në rrjetet sociale", thuhet në raport. Duke pasur parasysh fuqinë e madhe manipulative të dezinformimit dhe të lajmeve të rrejshme dhe të sajura, të cilat shpërndahen nën petkun e "e gazetarisë serioze", KEMM në drejtim të afirmimit më të madh të vetëregullimit,



ka miratuar rregulla të veçanta për internet portalet, të cilat janë anëtarë apo duan të anëtarësohen tek KEMM.

"Por, me gjithë miratimin e këtyre rregullave, KEMM u bën thirrje të gjitha mediave të punojnë me integritet profesional dhe të përkushtohen për zbatim të përkushtuar të principeve themelore të gazetarisë etike. Këshilli do të vazhdojë të vëzhgon mënyrën e të informuarit të mediave, si të atyre që janë pjesë të anëtarësisë, gjithashtu edhe të atyre që ende nuk janë anëtarë dhe do të bëjë thirrje për respektim të përkushtuar të Kodeksit të gazetareve, si parakusht për përkatësi në këtë trup të tonë, profesional, të përbashkët për vetërregullim të mediave".

## Sistemi financiar stabil, të kthehet besimi tek investitorët

Shkup, 5 mars - Sistemi financiar është stabil me rreziqe sistematike minimale. Jostabiliteti afatshkurtër i shkaktuar nga trazirat politike në prill dhe maj të vitit të kaluar është tejkaluar tërësisht, konstatoi në seancën e djeshme Komiteti për stabilitet financiar. Sipas ministrit të Financave, Dragan Tevdovski, sistemi financiar është stabil, funksionon normal dhe do të sigurojë mbështetje për rritjen e ekonomisë së Maqedonisë. Gjënë kryesore që e bëjmë tek politika fiskale, theksoi, është të sigurojmë stabilitet dhe rritje ekono-

mike. "Për herë të parë nga kriza, në tetë vitet e fundit kishte ulje të borxhit shtetëror dhe publik në shuma reale. Siguriam euroobligacion në kohën më optimale dhe për kushte më të mira të mundshme, ndërsa sipas të dhënave të fundit kthimi i TVSH-së ndaj kompanive bëhet në mënyrë joselektive dhe shpejtë. Nëse i shikoni muajt janar dhe shkurt të këtij viti, në raport me muajt e njëjtë të vitit të kaluar, kthimi i THVSH-së është më i madh për 1,4 miliardë denarë apo për 56 për qind. Kjo do të thotë se shpejtë

kthehet likuiditeti në kompanitë, ato të punojnë, kanë aktivitet dhe të investojnë", deklaroi Tevdovski. Sipas guvernatorit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, Dimitar Bogov, rreziqet prej sistemit bankar janë minimale. Bankat me kapitalizimin e tyre të lartë dhe likuidimin janë stabile dhe rezistuese ndaj goditjeve. "E gjithë kjo tregon se sektori bankar është veçanërisht mirë i kapitalizuar, me likuiditet të lartë dhe i përgatitur për ta mbështetur ekonominë e Maqedonisë", deklaroi Bogov.

## LAJME SHKURT

### Shtrenjtohen diseli dhe eurosUPER BS-98

Shkup, 5 mars - Prej mbrëmë në mesnatë çmimi i EUROSUPER BS - 98 dhe diselit po rritet, ndërsa EUROSUPER BS - 95 do të shitet me çmimin e vjetër, vendosi Komisioni Rregullator për Energjetikë. EUROSUPER BS - 98 shtrenjtohet për gjysëm denarë dhe çmimi i ri do të jetë 67,50 denarë për litër, ndërsa diseli dhe Vaji ekstra i lehtë për amvisëri shtrenjtohen për një denarë. Çmimi i ri i diselit do të arrijë 58 denarë për litër, ndërsa i Vajit ekstra të lehtë për amvisëri 46,50 denarë për litër. EUROSUPER BS - 95 edhe mëtej do të shitet me çmim prej 65,50 denarë për litër. Çmimi me pakicë i mazutit po rritet për 0.235 denarë për kilogram me çka çmimi i ri do të arrijë 28.109 denarë për kilogram. Rritja e çmimeve të derivateve të naftës vijoi pas rritjes së çmimit të naftës në tregjet botërore në periudhën e fundit 14-të ditore.

### Këmbimi 980.7 milion euro, rritet eksporti dhe importi

Shkup, 5 mars - Këmbimi i jashtëm i tërësishtëm tregtar i Maqedonisë në janar të këtij viti është 980,7 milion euro. Rritje shënojnë edhe eksporti dhe importi. Sipas Entit Shtetëror të Statistikës, eksporti arrin 420.606.000 euro dhe shënon rritje prej 27,9 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa importi arrin 560.136.000 euro ose 24,2 për qind më shumë. Deficiti tregtar në janar të vitit 2018 është 139.529.000 euro, derisa mbulimi i importit me eksportin arrin 75,1 për qind. Këmbimi i prodhimeve tregon se më së shumti eksportohen katalizatorë të transportuesve të metaleve të çmuara ose përbërjet e tyre, grupe të përçuesve për ndezje, për automjete, aeroplanë ose anije, pjesë të ulëseve dhe veshmbathje. Në import më së shumti janë përfaqësuar platini dhe legurët e platinit, vajrat e naftës dhe vajrat e fituara nga mineralet bituminoze (përveç të papërpunuara), prodhime të dërstiluara nga hekuri ose çelik i pa leguar, të platinizuara ose të pambështjellura, si dhe metale të tjera nga grupet e platinit dhe legurët e platinit. Në janar të vitit 2018, sipas vëllimit të tërësishtëm të këmbimit, Maqedonia më së shumti ka tregtuar me Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Greqinë, Bullgarinë dhe Serbinë.

### Ajdari zgjidhet Gjykatës Kushtetues

Shkup, 5 mars - Parlamenti i Maqedonisë dje e zgjodhi Naser Ajdarin, jurist i diplomuar dhe avokat shtetëror, për gjykatës të ri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë. Për zgjedhjen e Ajdarit nuk kishte debat në seancë parlamentare. Për propozimin votuan 62 deputetë, nuk kishte asnjë të abstenuar e asnjë kundër. Për zgjedhjen e gjykatësit kushtetues votuan edhe deputetët e pranishëm nga bashkësitë më të vogla etnike. Madje, votuan 22 dhe të gjithë ishin për zgjedhjen e Ajdarit për gjykatës kushtetues. Pas zgjedhjes Ajdari dha betim solemn para Kuvendit të Maqedonisë. Parlamenti në seancën e djeshme të 35-të i zgjodhi edhe Angel Solev, ish-gjykatës dhe Angele Iliovski, avokat për anëtarë të Këshillit të prokurorëve publikë.

NDIHMË PËR EFIKASITET MË TË MADH ENERGETIK NË SHTËPITË


# SUBVENCIONET: AI QË VJEN I PARI, SHËRBEHET I PARI

Janë paraparë 50 milionë denarë, prej të cilave 14 milionë tashmë janë shfrytëzuar për subvencionimin e stufave për peleta, ndërsa për masën kolektorë diellorë kanë paraparë gjashtë milionë denarë, si dhe 30 milionë euro për dritare efikase energjetike. Të gjitha masat ndahen sipas parimit "ai që vjen i pari, shërbehet i pari"

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 5 mars - Ministria e Ekonomisë edhe sivjet do ta subvencionojë përmirësimin e efikasitetit energjetik në shtëpitë dhe gjatë muajit do t'i publikojë thirrjet për kompensimin e një pjese të mjeteve për vendosjen e sistemeve termale me kolektorë diellorë dhe kompensimin e një pjese të mjeteve për blerjen dhe vendosjen e dritareve PVC dhe prej alumini të cilat do të jenë të hapura deri më 31 gusht të këtij viti. Këto dy thirrje janë pjesë e Programit të Qeverisë për promovimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë dhe stimulimin e efikasitetit energjetik në amvisëri për vitin 2018 përmes së cilit sivjet për herë të parë u nda kompensim i një pjese të shpenzimeve për blerjen e stufave me peleta. Për tre masat e Programit gjithsej janë paraparë 50 milionë denarë, të cilat do të ndahen përmes Ministrisë së Ekonomisë - prej të cilave 14 milionë tashmë janë shfrytëzuar për subvencionimin e stufave për peleta, ndërsa për masën kolektorë diellorë kanë paraparë gjashtë milionë denarë, si dhe 30 milionë euro për masën dritare efikase energjetike. Të gjitha masat ndahen sipas parimit "ai që vjen i pari, shërbehet i pari". Përmes masave për subvencionimin e qytetarëve për përmirësimin e efikasitetit energjetik të shtëpive deri më tani janë ndarë 70 milionë denarë për vendosjen e kolektorëve solarë me të cilat mbështeten 6.031 persona, si dhe 36 milionë denarë për vendosjen e PVC apo dritareve prej alumini me të cilat janë përfshirë 1.327 aplikantë, thonë nga Ministria e Ekonomisë. Masën për kompensim të kolektorit solar të blerë dhe të ndërtuar, Ministria e Ekonomisë e zbaton 10 vite, por për dallim nga paraprakja, këtë vit është sipas parimit "Ai që vjen i pari, shërbehet i pari". Kompensim të një pjese të mjeteve për blerje dhe instalim të sistemit për kolektorë termalë diellorë të blerë



dhe të ndërtuar do të mund të realizojnë personat të cilët nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën e kthimit të një pjese të mjeteve sipas kësaj mase në shpalljet paraprake që i publikoi Ministria e Ekonomisë në vitin 2007, 2009, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017. Një person mund të parashtrijë vetëm një kërkesë për marrjen e kompensimit. Që të mund t'i marrë mjetet do të duhet t'i blejë dhe ndërtuar në shtëpinë e tij sistemet për kolektorë diellorë pas ditës së shpalljes në shpalljen publike, përfundimisht me ditën e skadimit të tij. Për këtë do të duhet të parashtrijë kërkesë me deklaratë se kërkuesi nuk e ka shfrytëzuar kërkesën paraprake për kthim të një pjese të mjeteve, që mund të merret në arkivin e Ministrisë së Ekonomisë ose të sigurohet përmes faqes së internetit të Ministrisë [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk). Përveç asaj, duhet të dorëzojë dëshmi origjinale për blerje të kolektorit

diellor me llogari fiskale dhe faturë për shpenzimet e bëra për instalimin e tij. Me shpalljet në vitin 2007 dhe 2009, Ministria ka ndarë subvencione për ndërtimin e kolektorëve diellorë në vlerë të tërësisht prej nga nëntë milion denarë të 1.000 kërkuësve, përkatësisht nga 500 në vit. Në vitin 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 vlera e subvencionit arrinte nga gjashtë milionë denarë në vit me të cilat ishin subvencionuar 420 kërkuës në vitin 2011, 481 në vitin 2012, 514 në vitin 2013, 606 në vitin 2014, 591 në vitin 2015 dhe 625 parashtrues të kërkesave në vitin 2016. Vitin e kaluar ishin ndarë subvencione në vlerë prej 16 milionë denarë për 1.794 kërkuës.

Gjithashtu, Ministria e Ekonomisë për të dytin vit me radhë do ta zbatojë edhe masën për kompensim të një pjese të mjeteve për dritare PVC apo alumini të blera dhe të vendosura për çka janë paraparë 30 milionë denarë të cilat

do të ndahen pas shpalljes së konkursit, përfundimisht me 31 gushtin e këtij viti sipas parimit, i ai që vjen i pari shërbehet i pari". Kompensim të një pjese të mjeteve për dritare PVC dhe alumini të blera dhe të vendosura do të mund të realizojnë personat të cilët nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën e kthimit të një pjese të kësaj mase që për herë të parë e kumtoi Ministria e Ekonomisë në vitin 2017. Një person mund të parashtrijë vetëm një kërkesë për marrje të kompensimit. Në mënyrë që të mund t'i marrë mjetet, do të duhet t'i ketë blerë dhe vendosur në shtëpinë e vet dritaret PVC dhe të aluminit pas ditës së shpalljes së konkursit publik, përfundimisht me ditën e skadimit të konkursit. Vitin e kaluar Ministria ndau gjithsej 36 milionë denarë për vendosjen e dritareve energjetike dhe efikase PVC dhe të aluminit me të cilat u mbështetën 1.327 persona që parashtruan kërkesa.

## JANË SHFRYTËZUAR PARATË PËR SUBVENCIONE PËR STUFAT ME PALETA

Këtë vit për herë të parë Ministria e Ekonomisë ka ndarë subvencione për blerjen e stufave me paleta. Shpallja publike u publikua më 31 janar të këtij viti dhe duhej të jetë e hapur deri më 31 gusht, por megjithatë u mbyll shumë më herët sepse ishin shfrytëzuar të gjitha mjetet e parapara të cilat jepeshin sipas parimit "ai që vjen i pari shërbehet i pari". Ministria më 21 shkurt informoi se janë shfrytëzuar 14 milionë denarë të parapara për subvencionim të një pjese nga shpenzimet për blerje të stufave me paleta në amvisëritë, për këtë vit. Ata të cilët kanë blerë stufa dhe kanë aplikuar me



dokumentacionin e nevojshëm, ju mundësohet plotësimi i një pjese të shpenzimeve për blerje të stufave me paleta deri në 50 për qind, por jo më shumë se 500 euro në kundërvlerë të denarit për amvisëri për vitin 2018. Pas harxhimit të plotë të mjeteve për këtë qëllim, siç paralajmëruan nga Ministria e Ekonomisë do të përgatiten kërkesat për pagesë të kompensimit për 430 amvisëri të cilat i kanë plotësuar kushtet me Programin, ndërsa lista e kërkuësve të cilët i plotësojnë kushtet do të publikohet në ueb faqen e Ministrisë.



## Një Plan nacional për internet të brezit të gjerë

Shkup, 5 mars - Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës po përgatitë Plan operativ nacional për zhvillim të rrjeteve të shpejta dhe super të shpejta elektronike komunikative. Janë formuar katër grupe të cilat i mbajtën takimet e para në të cilat është konfirmuar dinamika e punës për periudhën e ardhshme. Një nga grupet punon në përcaktimin e kapaciteteve të lira dhe shfrytëzimin e tyre të ardhshëm tek rrjetet dhe mjetet ekzistuese elektronike komunikative, të ndërtuara me mjete publike dhe me të udhëheqë ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski. Sipas Mançevskit, nevojitet hartimi i të gjitha rrjeteve shtetërore elektronike komunikative me qëllim që të shfrytëzohen kapacitetet e tyre të lira për zhvillim të mëtutjeshëm, si dhe për nevojat e sektorit privat. Është cekur nevoja që Maqedonia - si vend kandidat për anëtarësim në BE, të harmonizohet me targetet "brodbend" të Agjendës digjitale të BE-së dhe Strategjisë së re për treg të vetëm digjital. Gjatë marsit pritet të përfundojë procedura për hartim, e deri atëherë institucionet shtetërore/publike, të cilat kanë rrjete elektronike komunikative, duhet të parashtrijë informata komplete për rrjetet e tyre telekomunikative. Pas hartimit, siç theksoi ministri Mançevski, nevojitet të konstatohet si më së miri do të shfrytëzoheshin kapacitetet e lira, ndërkaq si fazë përfundimtare, nëse mbeten resurse të disponueshme, ato do të ofroheshin për përdorim komercial. Tre grupet e tjera punojnë në konfirmimin e masave dhe aktiviteteve të nevojshme për vendosje të teknologjisë mobile 5G, për sigurim të koordinimit më të mirë të procesit të hartimit të territorit të Maqedonisë me rrjetet ekzistuese dhe të planifikuara të ardhshme brodbend elektronike komunikative dhe për konfirmimin e propozim masave për nxitje dhe rritje të interesit të qytetarëve për shfrytëzim të brodbendit.



## NDOTJA NË BALLKAN



Problemi i ajrit të ndotur në Ballkan ka marrë përmasa alarmuese. Kjo evidentohet edhe në statistikat e fundit të publikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Automjetet e vjetra ndër ndotësit më të mëdhenj

## AJRI NUK NJEH KUFIJ SHETËRORË

Shkup, 5 mars - Për shumë vite është anashkaluar zgjidhja e problemit të ajrit të ndotur në Ballkan, një problem që debatohet zëshëm në Evropën Perëndimore, ku në statistika thuhet se ndër 100.000 banorë, 23 vetë humbin jetën nga ndotja e ajrit. Vlen të përmendet se si në pothuajse çdo problem tjetër, poashtu edhe në këtë rast, vendet më pak të zhvilluara janë edhe më të prekura. Në Ballkan, numri i viktimave nga ndotja e ajrit në 100.000 banorë, varion nga 160 deri më 230 viktime. Bosnje-Hercegovina renditet si vendi më i prekur me numrin më të lartë të viktimave, duke u ndjekur në listë nga fqinjët e tjerë të Ballkanit, Shqipëria e më pas Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Serbia. Rajoni i Ballkanit është pjesa e Evropës me atmosferën më të ndotur.

Vlatka Matkoviç Puljiq, përgjegjëse për shëndetësinë dhe energjinë për rajonin e Ballkanit në Aleancën për Shëndetësi dhe Mbrojtje të Mjedisit HEAL me qendër në Bruksel, për DW thotë se problemi i ndotjes së ajrit në këtë rajon është "problem i tmerrshëm", dhe ndër ndotësit më të mëdhenj ajo rendit industrinë, pastaj trafikun dhe lëndët djegëse. "Si problem kryesor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar janë termocentralet, e në nivel lokal është trafiku dhe lëndët djegëse kryesisht për ngrohje".

Emetimet e lartë të grimcave të dëmshme të ajrit në një vend do të thotë se ato dëmshme mund të përfundojnë në vendet e tjera fqinje. "Nuk mund të luftohet ndotja e ajrit vetëm në komunitetin lokal. Nëse ka një ndotës që është pranë dhe nuk mund të ndalohej emetimi, sepse i takon një shteti tjetër, në këtë rast duhet bashkëpunim ndërshtetëror. Për shembull, nëse Kroacia dëshiron të bëjë diçka për të përmirësuar cilësinë e ajrit, nuk do t'ia arrijë qëllimit, sepse Serbia dhe BH si fqinjë e ndotin ajrin. Dhe ajri nuk njeh kufij shtetëror". Matkoviç Puljiq më tej thekson se bashkëpunimi midis

vendeve është i pashmangshëm, për të bërë hapa konkrete drejt filtrimit ose mbylljes së termocentraleve.

## AUTOMJETET E VJETRA, MJETE KRYESORE TË TRANSPORTIT

Në vendet e ish-Jugosllavisë ende industria shihet si ndotësi më i madh i ajrit. Ndërsa Shqipëria është e prekur rëndë nga një problematikë e natyrës tjetër. "Edhe sot pas 27 vitesh industria në vend është shumë pak e zhvilluar dhe nuk përbën ndotësin kryesor në mjedis, ndërkohë që transporti që renditet i dyti sektor në konsumin e energjisë është ndoshta i pari në ndotjen që shkakton në mjedis", thotë Olsi Nika, nga organizata EcoAlbania për DW. Ndërkohë që në vendet e tjera të Ballkanit luftohet kundër një problemi që shkaktohet për të siguruar një standard ekonomik, në Shqipëri vjen problemi i ndotjes së ajrit pjesërisht vetëm nga transporti. Kjo bëhet e qartë në zona të kryeqytetit ku "normat e PM 10 dhe PM 2.5 (substancat e ngurta të mbetura pezull në ajër) janë disa herë më të larta se normat e lejuara në një kohë ku nuk operojnë fabrika industriale", thotë Drejtori Ekzekutiv nga EcoAlbania, Olsi Nika. Ky problem haset edhe në zonat e tjera urbane të Shqipërisë. Kur kemi ende një rrjet komunikimi, i cili le shumë hapësirë për të dëshiruar, kryeqyteti duket qartë se nuk mundet as për afërsisht t'i plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve.

Ndërkohë në Tetovë, edhe pse si ndotësi i tretë më i madh në renditje - qyteti nuk ka as transport publik. Arianit Xhaferi nga organizata Eco Guerrilla kërkon sa më parë vendosjen e transportit publik, që të ofrohet një alternativë tjetër krahas automjeteve private për qytetarët. Për të njëjtin problem flitet edhe në Bosnjë, ku transporti është ndotësi i dytë më i madh. Për DW, nga organizata Eco Akcion nga Sarajeva, thuhet: "kur importohet një automjet në BH është e nevojshme që automjetet të kenë motor EURO 4. Megjithatë, ky nuk është problemi më i madh. Problem akoma më alarmues është mosha mesatare e automjeteve në rrugë. Një numër i konsiderueshëm i automjeteve që ende lëvizin janë të prodhuara në vitet 1980". Një gjendje pak a shumë e njëjtë gati në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor.

## VALË E RE E AUTOMJETEVE TË VJETRUARA DIZEL DREJT BALLKANIT

Pas vendimit të Gjykatës Federale Administrative të Gjermanisë, ku bashkitë e komunat kanë të drejtë të vendosin për ndalimin e automjeteve dizel më të vjetër se ato me standard EURO6 ka rënë vlera e automjeteve dizel në Gjermani. Kjo po rezulton me një fluks të automjeteve Diesel drejt Ballkanit në veçanti në Shqipëri, ku automjetet gjermane kanë një prestigj shumëvjeçarë. Në janar 2018, ndotja e ajrit në Prishtinë arriti një

nivel gjashtë herë më të lartë se normat e caktuara. Masat ekstreme, të cilat u ndërmoren me ndalesën gjithpërfshirëse të komunikacionit në qytet, ishte një reagim reflektiv, gjë që nuk mund të konsiderohet si zgjedhje e përhershme e problemit. "Ndërhyrja e autoriteteve për përmirësimin e situatës të paktën deri tani ka rezultuar të jetë e pamjaftueshme. Megjithatë vlen të përsëritet nismat e tilla të ndërmarrja nga Ministria e Mjedisit për të vendosur si kufi të poshtëm limit përdorimin e motorëve Euro 5. Kjo mund të jetë një masë, e cila padyshim do të rëndojë mbi xhepat e qytetarëve", thotë Nika nga EcoAlbania. Po të shohësh zhvillimet e fundit në tregun e automjeteve, ndoshta nismat e Ministrive të Ballkanit duhet të jenë më të shpejta. Rregullimi i importit të automjeteve me motor Diesel ndoshta do të shmangte në kohë rrezikun nga perëndimi.

## ANGAZHIMET E QYTETARËVE KUNDËR NDOTJES SË MJEDISIT, PJESËRISHT TË SUKSESSHME

Për të mbrojtur mjedisin duhet vetëdijësim më i lartë i qytetarëve në përmasa rajonale. Shumë organizata ekologjike të Ballkanit Perëndimor janë duke luftuar në mënyrë aktive këtë problem. Olsi Nika thotë se që të jesh qytetar i mirëfilltë duhet "të jesh i angazhuar e aktiv duke rritur presionin e llogaridhënies kundrejt vendim-marrësve e politikëbërësve

për të ndërmarrë hapa dhe veprime që të përmirësojnë situatën e ndotjes apo problematika të tjera që lidhen me përditshmërinë tonë". Duke patur parasysh detyrën e tyre si qytetarë, Xhaferi nga Eco Guerrilla kërkon nga institucionet përkatëse të mos e lënë mbrojtjen e mjedisit në vullnetin e mirë të qytetarëve. Më tej ai thekson që "deri tani kemi parë shumë rekomandime, fare pak masa (për të mos thënë aspak), dhe gjoha e ndëshkime ndaj kundërvajtësve që nuk vihen në fuqi". Organizata nga qyteti i Tetovës është një shembull pozitiv në atë se si mund të ndryshohen politikat ndaj qytetarëve. Kjo u demonstrua duke protestuar disa vite radhazi për ajër të pastër në qytetin e tyre. Kërkesa kryesore ishte që termocentrali "Jugohrom", me vendndodhje afër qytetit të Tetovës të vendoste filtra sipas rregulloreve dhe ligjeve evropiane. "Sukses më i këndshëm do ishte vendosja e filtrave, përmbushja e kërkesave dhe standardeve ekologjike me çka s'do humbte askush punën, por u desh bërë ajo që duhej bërë sepse ata (dukej qartë) se talleshin me jetën dhe shëndetin e tetovarëve, dhe as që mendonin të bënin hap përpara në kuptimin e përmbushjes së standardeve", thotë Arianit Xhaferi, duke shprehur keqardhje për qytetarët që humbën vendin e punës. Në anën tjetër, Xhaferi është shumë mirënjohës ndaj qytetarëve që mbështetën organizatën gjatë aktiviteteve dhe që ishin gjithmonë iniciativa paqësore. "Rezultatet janë të dukshme, Tetova tani më nuk është qyteti më i ndotur maqedonas".

Tetova është shembull pozitiv, por a do të mundet Ballkani të ndryshojë të ardhmen si rajon? Shpresa ka, po ashtu edhe shembuj pozitiv edhe pse janë shumë të pakta në numër. Iniciativa të ardhshme me kapacitete dhe fuqi më të madhe ndryshuese janë të nevojshme për të minimizuar efektet e rrezikshme të ndotjes së ajrit për shëndetin e njeriut. (DW)



Iu ktheva dashnis s'vjetër! Kolumneve! Ashtu e nisa veten, përmes shkrimeve n'gazeta. Kjo ishte dashnia ime e parë! E fort, sa n'asht ngjit m'u kap! Kolumnet n'Prishtinë! Atëherë, i besoja fjalës, idesë, poezisë, dashnisë, mikut, protestës, revolucionit, Kombit... Shtetit? Ah jo, nuk i besoja shtetit. Unë nisa dashnin për shkrimin në shtet që u shkatërrua dhe pa më pyetur kush, m'rrethuan me shtet t'ri, zvarrë tërhequr nga ai konglomerat që rra si domino! Pastaj po aq t'vështirë e kisha t'i besoja shtetit të ri. Thu ti se më mbet hatri përse s'më pyetën edhe mua atij referendumit me pyetje ambiguine, por vetëm më të vjetrit nga unë! I vjetri iku, u bo copë e grim pa i besuar unë dhe ashtu e pa zënë besë, m'u deshtë t'a pranoi jetën në shtetin e ri. Hmmm, e keni menduar ndonjëherë këtë traumë? E quajne psikologët: TRAUMË. Unë po ju pyes nëse e keni menduar ndonjëherë më gjatë e më thellë se si ndodhi KALIMI yt rrethuar n'kufij të ri? Do gjeni shumë përgjigje dilemave tuaja t' brendshme se përse ndiheni ende pezull disi! Pa gjetur përgjigjet vet, s'do jeni rehat kurrë!

Çdo gjë ka të bëjë me Kalimin e Madh!

U derdh gjak! Shumë gjak! Por ende nuk marr guximin t'i flas time bije se gjenerata ime ishte pjesë e shtetit të madh që nuk koaguloi mjaftueshëm gjakun, e kur ky shtet i madh u bë copë e grim e pa pik mëshirë la të rrjedh gjaku - gjenerata ime u shpërnda si pluhuri i barutit, gjithandej...Kisha çaste kur mendoja se të gjithëve na përbiu toka, sikur u shpërbëmë, një zombizëm ky trishtues, biles ndjeja lukthin tek më tërhiqej përbrenda nga frika se kush do krijonte vazhdimësinë e kombit-për të cilin im atë lente kryt! Ose ose, kush do i mblidhte kujtimet more, kush do e shkruante historinë e gjeneratës sime se?! Unë!? Çfar' ngarkese, unë s'di për historinë!!!

"Kombi bij, kombi!"- alamenti amaneti më la im atë! Dridhem kamb e kry edhe tani kur e kujtoj dhe e shndëroj "fët e fët" këtë amanet në TABU! E kam më lehtë! Çka u bë me kombin Bab'? Ngre supet, tërheq këndet e buzëve teposhtë, ngrys vetullat disi dhe vet'përgjigjem: S'DIJ!

Pastaj (përsëri gjenerata ime a), ishte ajo tema Shteti Komb, apo Kombi Shtet! Phuu sa i koklavitur pa gjene më dukej ky binom. Përsëri Babai im: "Modeli gjerman bijjijj!". Si nëpërdhembë ngjitqiellzës e zgjaste këtë "jijj" Ai, e ndjeja, kish guxim ende! Unë, shndërohesha në Hamlet, herë shtrirë përtoke, herë ngritur më këmbë fantazish! Më duhej t'a thjeshtësoja kuptimin e çiftit Shteti Komb apo Kombi Shtet,

## Adelinë, ç'të panë sytë!

Nga  
Adelina MARKU



që s'bën njëni pa tjetrin. Diku diku befnin do troha debatesh t'zymta mbi multikulturalizmin si opsion shpëtimi, por ishin si pshtymthka që të dalin nga goja bash kur banftoft pisk! Thu ti t'pshtjellohen me qyrrat e ligavesh n'këtë lamsh langjesh, qyra - liga! E dini se përse këto debate ishin si pshtymthka, si ligthka e qyrra? Sepse edhe ata që shkruanin mbi këtë opcion, tybe në i besonin...!

Multikulturalizmi është i kushtueshëm, do "nacionalizëm" ekonomik, do dashuri për veten, për Shtetin, një konkurrencë legale, lirinë ndërkulturore e shpall majave të demokracisë...Kush do bënte more multikulturalizmin? Ata që vuanin nga "multiple disorder of political personality", ata që zhvishnin brekë partiakë dhe vishnin do tjera n'çast, ata që bëheshin nga radikalë nacionalistë në liberalë, ata që gënjejnë se kauza e gjakderdhjes mes popujve bëhet me qëllim dashurie më të fortë pastaj?!

Broçkulla! ...Ku t'a ngjis besimin se?

Kështu nisi e vazhdoi jeta në shtetin e ri, përmes ndërgegjes rrenë! U barazu vetëdija me nënvetëdijen! Lesh Arapi i thon'! Por, po deshe të ishe "cool"- mundeshe të flasësh për multikulturalizmin! Bile edhe gratë më të shëmtuara kur flisnin për multikulturalizmin, thu ti mernin

njësharm multikulturore! Asnjëanësh a, as e bukur as e shëmtuar! Cool a! Se mo burrat, ato pa gjene boeshin si pa gjini...! Burra pa tope.

Pastaj kur edhe konflikti i 2001-shit u bo për këtë sharm multikulturore (u derdh gjak a, që të duhemi më shumë në paqe!), unë e gjeta veten të dalur mode! Isha anakronike, isha jo-cool, isha nacionaliste (!?), yyy sa vulgare... "Babai yt kish ndjekur shkollë nacionalistësh!" - shkruanin, aty te Dosja e tij!? Unë e dija liberal t'em atë! Shteti më thotë tjetër gjë!? Kush ishte më i forti, Shteti ose Baba në mua!? Ç'ishte kjo shkollë e tollovitur, të kish gabuar kaq shumë im atë, ai vazhdimisht thoshte se është Kushtetuta burimi i konfliktit, po- ajo copë letre parimesh Sovrani krijonte ngërçin artificial në shoqëri! Ai ishte Liberali i Madh, këta rreth tij kishin lëpirë dëngla e ishin ngjitur posteve! Ore, isha ngulur në TRAUMËN e dytë a! Çdo gjë ka të bëjë me Kalimin e Madh, përsëri! Por ky i 2001-ishit ishte tip kalimi KALIMTH- një si tip stuhie, aty vrap u ngjiten të gjithë multikulturoret, (pseudo)nacionalistët e djeshit, të gjithë gratë e bukura e të shëmtuarat, të gjithë burrat dikur me tope e tuj bo vrapin e posteve kishin hup kambësh topet, të gjithë gazetarët bon namin tuj sha nacionalistët (ashtu na quanin, vulgarët ishim ne, primi-

tivë!), por ama për TRAUMËN e 2001 - nuk folëm. Ashtu si temën mbi kombin, e bëmë "fët e fët" temë TABU!

S'morëm vesh gjë! Pastaj kishin gabuar ata që thoshin se revolucionin i han fëmijët e vet! Përmes revolucionit bënë barqet më të mëdhenj se vetë Buda, revolucionarët! Shpallën Nirvanën edhe atëherë kur ekonomia shkoi në djall!

Dhe pastaj, qeverisjet shkolin e vinin! Askush nuk foli për TRAUMAT, askush nuk i hapi TABUTË...të gjithë neve luajmë multikulturoret, dhe multikulturore vjedhim shtetin. Pse ky qenka multikulturalizmi?! Është sikur prioritet strategjik i koalicioneve një pas një: Vjedhja e Shtetit! Pastaj filluam multikulturalisht t'a zbrazim shtetin nga të rinjtë! Gjersa e shkretuam mirë e mirë! Tani jemi në fazën: Gishtin në gojë! Elhamdulillah-u biles u bë pjesë e politikës! Thu ti se i krytëm të gjitha fazat e një procesi normal politik zhvillimor dhe na mbet keq feja jashtë politikës. Huxhum, huxhum edhe fenë në politikë! Ja kështu neve, guxam edhe me fenë a. E bëmë pjesë mitingjesh politike, e nxorën nga shtëpia e fesë- nga Xhamia, fët e fët, kush ma shumë e kush ma pak-ama nga një copëz Elhamdulillahu e thonim se! Unë që mbaja veten shqiptare me fe, isha e pa mend, ç'ne kjo "shqiptar me fe"! Po

cili na qenka Pejgamberi jot se? - dëgjoja cinizmin e atyre që sollën padrejtësisht fenë në politikë. Iu thosha unë: Kombi, Gjuha, Kultura...

Më shpallën të marrë! (ndoshta dhe isha ...!) Po unë?! Po gjenerata ime!?! A jam zombizu apo hamletizu...!?! Denatryru do thosha, as Zombi por as Hamlet kemi mbetur! Jemi ngulur në një zonë ku vetëm mençuri nuk ka, çdo gjë tjetër ka! Eps! Kur mungon mençuria, bëhemi të gjithë neutralë! Pa ide rezistuese, pa kapacitet thithës madje, pa resurse zhvillimore! Pa Fe, pa Komb! ...Biles më duket vetja se në zgjedhjet e ardhshme tuj dasht me ngjall Hamletin do bëj vrap mu si ajo italiana që i kish dal Berlusconi me gjinj të jashtë, thu ti se do e trembte magnatin miliarder të hedhë votën për veten. Problemi është se nuk iu trembet kush gjinjve të zhveshura të një Nane plot revolt para kutive t'votimit, sepse të gjithë ata të rinj që pinë tamblin nga gjini i nënave tona, ikin, ikin masivisht. S'ka respekt për gjinj të kemi tepër! Mjafton të bëhemi ministra, ministresha, deputetë e drejtor...hahahahhaaaa, Adelinë ç'të panë syt!

(Pikëpamjet e autorit janë individuale dhe nuk paraqesin qëndrime të institucionit ku punon)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovrasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazelë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - nr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 5 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

# Tani forca përpara, jo më kështu!



Nga  
Ines POHL

**P**ra edhe njëherë punët përfunduan mirë. Me një shumicë të qartë prej 66%, anëtarët e Partisë Socialdemokrate i thanë "Po" një aleance të re qeverisëse me kancelaren, Angela Merkel. Para pashkëve, në fund të marsit duhet të jetë gati qeveria e re. Rruga deri këtu ishte e mundimshme. Dështime të bisedimeve të koalicionit. Politikanë të njohur, si ylli për një kohë të shkurtër i SPD-së, Martin Schulz ngecën në gjysmë të rrugës. Kancelarja e dobësuar, sepse nuk po ia dilte në një botë të re të shumë partive të vogla të krijonte qeverinë. Për Gjermaninë një situatë e re. Që nga themelimi i Republikës Federale në vitin 1949 gjithmonë njëra nga partitë e mëdha kërkonte një partner, nëse nuk arrinte të qeveriste e vetme. Kaq. Edhe në 12 vitet e fundit situata dukej e parashikueshme. Angela Merkel ishte e mbeti kancelare. Gjëra të tjera nuk interesonin aq shumë botës. Me hyrjen në parlament të partisë konservatore të djathtë, AfD mori fund në Gjermani bërja politikë në forma të rehatshme. Partitë e mëdha po bëhen gjithnjë e më të vogla, të voglat më të mëdha. Dhe



me këtë po komplikohet gjithnjë e më shumë gjetja e mazhorancave qeverisëse.

## GJERMANIA LUFTON PËR IDENTITETIN

Kjo situatë e trazuar reflekton atë që po ndodh në Gjermani. Të dyja partitë popullore i kanë zhgënjyer votuesit e tyre tradicionalë kaq shumë, sa që ata tani gjithnjë e më shumë po votojnë radikalisht, në skajin e djathtë si edhe atë të majtë. Ish-partitë e mëdha nuk kanë koncepte politike për të reaguar ndaj frikës së shumë gjermanëve që ndjehen të pasigurt, të mbingarkuar, që kuptojnë se si u shkrihen para syve rrethanat e njohura e të vetëkuptueshme të

Angela Merkel më në fund do mund të krijojë qeverinë e re. Do të jetë mandati i saj i fundit e më i vështiri. Tani shtrohet çështja, çfarë do që të jetë Gjermania në të ardhmen



jetës. Ato nuk kanë përgjigje për sfidën se si shkojnë me njëri-tjetrin globalizmi, integrimi, identiteti. Edhe në politikën e jashtme nuk dihet qartë, se çfarë roli do të luajë Gjermania në botën e Trump-Xi-Putin dhe se çfarë do të thotë në fund të fundit të marrësh me shumë përgjegjësi në politikën e jashtme dhe të mbrojtjes.

Muajt e fundit të një debati të vështirë mund të jenë zilja e zgjimit, për të cilën Gjermania ka nevojë. Politikanët duhet t'u japin sërish zgjedhësve ndjesinë, se ata dëgjojnë. Politika duhet të provojë, se e ka kuptuar, se ka edhe një agjendë të popullsisë, që duhet dëgjuar pa rënë në nacionalizma të vjetra e të rrezikshme. Në këtë pikë koalicioni me bazë të gjerë (CDU/CSU e SPD) edhe pse qeveris bashkë duhet të gjejë një rrugë debati brenda aleancës, partnerët duhet të dallohen prej njëri-tjetrit. Vetëm profilet e qarta, të dallueshme do mund të ndalin humbjen e zgjedhësve. Nëse kjo nuk arrihet, të dyja partitë e mëdha në zgjedhjet e ardhshme në vitin 2012 do të fundosen së bashku. Frika nga duartrokitjet e palës së gabuar, nuk duhet të luajë rol, ashtu si nuk

duhet shkuar për peshkim votash në kampin nacional të djathtë të AfD-së.

## ZILE E FORTË ZGJIMI

Angela Merkel mund ta krijojë tani qeverinë. Rruga deri aty ishte një sinjal i qartë, se duhet luftuar sërish për kursin politik. Me hyrjen e AfD-së në Bundestag është zgjuar një kulturë debati, që të inkurajon. Politikani i Gjellbër, Cem Özdemir ishte njëri prej tyre që mbajti një fjalim të fortë se si duhet vepruar me urrejtjen e përjashtimit. Një fëmijë i emigrantëve turq tregoi, se dashuria dhe krenaria për atdheun Gjermani nuk duhet të jenë patjetër kategori të kohës së vjetër nacionalsocialiste. Por një burim fuqie, që ndihmon për të mbrojtur marrëveshjen e një shoqërie pluraliste e liberale, që karakterizon Gjermaninë. Fjalime të tilla ka pasur kohë që nuk janë dëgjuar. Tani fillon koha e grindjes për argumentin më të mirë, epoka pa alternativa me urdhësesë ka marrë fund. Një fillim i mirë pas një faze të paralizës politike, që ka zgjatur më shumë se pesë të muaj të krijimit të qeverisë.

Sistemin e vjetër politik italianët e mbyllën në sirtar. Pas zgjedhjeve triumfuan populistët, si majtas ashtu edhe djathtas. Por ata nuk e bëjnë dot qeverinë. Më mirë kështu



**V**otimet në Itali nuk nxorën asnjë mazhorancë të qartë duke dërguar me një sinjal shqetësues. 60% e votuesve e votuesve italianë kanë vendosur këtë herë për partitë populiste, - ose nga ana e majtë për Lëvizjen e Pesë Yjeve ose nga e djathta për partitë populiste, përfshirë edhe neofashistët. Sa të zhgënjyer e të revoltuar duhet të jenë ndërë ita-

## Italianët votuan kaosin

lianët me stilin e qeverisjes në Itali, që të gjejnë strehë tani tek populistët, që premtojnë gjithçka, luajnë me frikën, e që shumë pak do të realizonin nga ato që thonë?

### ITALIANËT E PERCEPTOJNË SHTETIN E TYRE SI TË PAAFTË

Silvio Berlusconi, një plak i ringjallur 81 vjeçar me afro 15% të votave të marra shihet si shprësdhënës, megjithëse si askush tjetër ai qëndron për sistemin e vjetër italian. Ndërsa kundërshtari i euros dhe armiqësor ndaj të huajve, Matteo Salvini ka dalë madje para Berlusconit, Të mos harrojmë ata që nderojnë ende Musolinin, "Vëllezërit Italianë" që kanë kandiduar në kampin djathtist. Përballë tyre nga kampi tjetër qëndron Lëvizja e Pesë Yjeve. Liderët e saj premtuan mrekullira, ata duan të shpenzojnë para që Italia nuk i ka. BE është fajtori që duhet t'i paguajë më shumë Italisë, sipas tyre. Italianët duan diçka

të re, diçka tjetër. Shtetin e tyre ata e perceptojnë si plotësisht të paaftë dhe të vjetëruar. Kjo është fatura e dështimit të listës së majtë, të drejtuar deri më tani nga socialdemokratët qeverisës. Para zgjedhjeve ata u përçanë dhe gjenden, ashtu si SPD-ja gjermane, në rënie të pandalshme. Ish-shpresa e italianëve, Matteo Renzi dështoi në skenën politike. Reformat në Itali nuk ecën përpara, ekonomia rritet shumë ngadalë, numri i të papunëve është shumë i lartë, problemet me numrin e lartë të azilkërkuesve nuk janë zgjidhur. Aparati shtetëtor përpin shumë para, drejtësia është e ngadaltë dhe joeficiente. Lista negative për ekonominë e tretë të eurozonës mund të vazhdojë edhe më tej.

### KOALICIONET TË PAMUNDURA

Mesazhi i votuesve në këto zgjedhje: Si tani nuk mund të vazhdohet më. Por në fakt kështu

do të vazhdohet, sepse të tre blloqet e mëdha e pengojnë njëra-tjetrën në parlament, e koalicionet duken të pamundura. Të paktën para zgjedhjeve ato kanë përjashtuar kombinime të mundshme. Madje edhe një koalicion, realisht i pamundur, mes partisë së Berlusconit dhe socialdemokratëve nuk ka shanse numerike për të arritur mazhorancën në dy dhomat e parlamentit. Nëse asnjë nga partitë e tjera nuk lëviz nga ky pozicion, presidenti italian duhet të emërojë një qeveri teknike, që duhet të drejtojë vendin deri në zgjedhjet e tjera. Këtë model Italia e ka përjetuar shpesh. Ai nuk reflekton vullnetin demokratik të votuesve, por të paktën sjell marrëdhënie pak a shumë të parashikueshme.

Aleati francez i Lega Nord, Fronti Nacional i Le Pen e uroi Salvinin për rritjen e numrit të votave. Për fat të keq Le Pen ka të drejtë, kur thotë se për Bashkimin

European kjo natë zgjedhore nuk ishte një natë e mirë. Me numrin e lartë të votave të populistëve një vend i rëndësishëm i BE rrëshqet në të njëjtën anë si ndërkohë Hungaria, Polonia, Greqia dhe Austria. Aty populistët ose janë në pushtet ose bashkëqeverisin. Edhe në Gjermani populizmi po marshon. Deri më tani as në Bruksel dhe as kryeqytetet e tjera europiane nuk është gjendur receta për të ndaluar populistët dhe nacionalistët. Italia nuk ka këllqë për të përballuar një krizë të gjatë qeveritare. Nëse tregjet e humbasin besimin në zhvillimin e rregullt të Italisë, mali i lartë me borxhe i këtij vendi mund të bëhet së shpejti tejet i shtrenjtë, madje edhe i pafinancueshëm më. Pak shpresë të jep vlerësimi i një votuesi në një qendër zgjedhore kur thotë: "Ne italianët do ta kalojmë edhe këtë situatë. Gjithmonë në një lloj forme ia kemi dalë megjithë këtë sistem të mbaruar". (DW)



Nga  
Bernd RIEGERT



## KLASIKËT FRANCEZË SJELLIN PRANVERËN NË TIRANË

Rreth 200 tituj me emrat më të rëndësishëm të filozofisë, letërsisë, antropologjisë, arkitekturës apo artit francez të shekullit XX do të zënë vend në Bibliotekën Kombëtare, ku sot përveç pasurimit të fondeve të saj do t'i dedikohet një hapësirë e posaçme, një sallë e re leximi; Paul Valery, Marcel Proust, Milan Kundera, Derridas, deri te krijimtaria në gjuhën frënge të Kadaresë nga përkthimi mjeshtror i Jusuf Vronit



veçantë kjo sallë e re. Ky fond i ri, donacion i Ambasadës Franceze, përfshin emrat më të rëndësishëm të filozofisë, letërsisë, antropologjisë, arkitekturës apo artit francez të shekullit XX. "Janë rreth 200 tituj, të viteve të fundit, botime nga shtëpitë botuese më të njohura franceze.

Studiuesit dhe lexuesit shqiptarë frankofonë do të kenë mundësinë të marrin në dorë, për një njohje më të thellë, botime rreth rrymave letrare, teorive dhe ideve filozofike që dominojnë shekullin XX, me ndikim të jashtëzakonshëm në të gjithë kulturën dhe shoqërinë evropiane", thuhet në njoftimin për mediat. Në bibliotekë do të zërë vend edhe krijimtaria e plotë letrare të poetit Paul Valéry dhe prozatorët Marcel Proust dhe Milan Kundera. Krahas tyre vijnë edhe veprat e kritikëve, teoricienëve e filozofëve të rëndësishëm, si: vepra e plotë e kritikut e studiuesit të tekstit Roland Barthes; e filozofit Michel Foucault; idetë dhe teoritë e fenomenologjisë së Jacques Derridas dhe Gilles Deleuze; intelektualit dhe shkrimtarit Georges Bataille; apo vepra e sociologut Emile Durkheim etj. Krahas tyre janë edhe veprat e shkrimtares feministe, filozofe dhe kritike Hélène Cixoux, filozofit dhe gjuhëtarit Jean-Michel Henny, poetit Gérard Berréby, shkrimtarit Julien Gracq, Jean Borriel etj. Një vend të posaçëm ndër librat e dhuruar nga Ambasada franceze në Tiranë zënë edhe disa botime në gjuhën frënge të Ismail Kadaresë, që vijnë në përkthimin mjeshtror të Jusuf Vronit dhe Michel Métais. Kultura franceze, veçanërisht filozofia dhe letërsia ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në mendimin filozofik Perëndimor përgjatë shekujve, një pjesë e rëndësishme e tyre janë pjesë e vyer e fondeve të Bibliotekës Kombëtare. "Salla Franceze e leximit, me rreth 3700 libra, të cilat përfshijnë të gjitha fushat e dijës, është një hapësirë e re leximi në Bibliotekën Kombëtare. Ajo

do të ketë literaturë në pasur në gjuhën franceze, duke u ardhur në ndihmë të gjithë studiuesve, studentëve dhe lexuesve të kryeqytetit, si dhe përmes veprimtarive të shumta kulturore në shërbim të shkëmbimit të dijës dhe informacionit", thuhet në njoftimin e Bibliotekës Kombëtare.

### "POLINA" E PRELJOCAJT

Koreografi i njohur Angjelin Preljocaj do të vijë përsëri në Tiranë, ku do të sjellë filmin e tij "Polina" në kuadër të aktiviteteve kulturore të "Pranverës Frankofone". Sipas Ambasadës Franceze, Angjelin Preljocaj së bashku me bashkëshorten e tij Valerie Muller do të vijnë në Tiranë më 23 mars. Filmi "Polina" shënon debutimin si regjisor kinematografik të Angjelin Preljocaj, që është njëkohësisht edhe autor i skenografisë në çift me të shoqen Valérie Müller. I frymëzuar nga Polina, personazh vizatimor i Bastien Vivès, rrëfen historinë e një vajze të vogël ruse, e cila u bë balerinë e Bolshoit dhe nëpërmjet një lidhjeje dashurie të komplikuar me një kërcimtar francez, zbuloi një mënyrë tjetër të të kërcyerit. Filmi "Polina, vallëzimi i jetës së saj", zhvillohet në Moskën e viteve nëntëdhjetë, kur perdja e hekurt sapo kishte rënë. Këtu Polina, një vogëlushe tetëvjeçare, e cila vjen nga një familje e thjeshtë dhe që ka prirje të mëdha për kërcimin, zgjidhet për të ndjekur leksione balleti në shkollën e vështirë të mjeshtrit Nikita Bojinski që do ta përgatisë për në Teatrin Bolshoi, pjesë e të cilit do të bëhet në moshën 18-vjeçare. Polina takon dashurinë e saj dhe nëpërmjet saj zbulon një mënyrë të re të të kërcyerit falë balerinit francez Adrien, një bashkëmohatar të saj që do ta çojë në Aix-en-Provence, ku balerina e re do të mësojë sekretet e kërcimit bashkëkohorë. Parabola e saj do të përbushet në vende, si Anversa, Montpellier, Avignone, kur Polina do të jetë bërë grua. (MAPO)

## Pse refuzohet Rade Šerbedžija të luaj Adem Jasharin?!

Disa fjalë për ata që nuk e dijnë (edhe pse do të kisha dëshirë që të tillë të ketë sa më pak) se kush është Rade Šerbedžija

Daut DAUTI/LONDËR

Rade Šerbedžija dhe Bekim Fehmiu, pa kurrëfarë dyshimi, janë aktorët më të mirë të të gjitha kohërave që kanë jetuar dhe vepruar në ish Jugosllavi. Është çështje e shijes dhe e neutralitetit të cilësohet se cili nga këta dy, si aktor, qëndron mbi tjetrin.

Mund t'ju rrëfej se si e njoh unë Rade Šerbedžija-n. Šerbedžija është aktor serb i cili u detyrua ta lëshoj Kroacinë kur filloi shpërbërja e Jugosllavisë pasi që nuk pajtohej me luftën. Shkoi në Beograd dhe u përzu edhe nga ky vend për shkak se nuk pajtohej me regjimin e Millosheviqit. Madje, në një rast një nacionalist serb ju kërcënuar që ta vriste duke gjuajtur me armë në një takim ku gjendej ai dhe u quajt 'tradhëtar serb'.

Pastaj Šerbedžija erdhi në Londër për shkak se gruaja e tij, Lenka Udovički, kishte një post në ambasadën e Kolumbisë dhe punonte si aktore në kryeqytetin britanik. Atoja e njohur Vanessa Redgrave, e cila angazhohej për të drejtat e shqiptarëve të Kosovës, ia kishte lënë në dispozicion tërë zyrën e saj Rade Šerbedžija-s nga ku ai shpejt depërtoi në rolet e filmave më të njohur botëror. Tashti Šerbedžija është kthyer për të jetuar në Kroaci të cilin shtet ai e konsideron si vendin e tij.

Më duket se ka qenë viti 1995 ose 1996 kur nëpërmes Vanesës rashë në kontakt me Šerbedžija-n nga i cili kërkova që të më jepte një intervistë për revistën ŽERI. Ai pranoi me kënaqësi. Kurrë nuk kam takuar serb sikur Šerbedžija-n që fliste me respekt të madh për shqiptarët. Mendonte se shqiptarët po keqtrajtoheshin nga regjimi i Millosheviqit dhe se meritonin të drejtat e tyre në Kosovë. Për Bekim Fehmiun fliste me një respekt sikur nxënësi i mirë që flet për ndonjë guro të tij të madh. Madje për Bekimin ai e komponoi dhe e këndoi këngën e njohur 'Pjesma za Bekima' (Ej Boro, beli Boro). Më tutje, Šerbedžija mendonte se aktorët më të mirë në Jugosllavi, si në teatër ashtu edhe në film, ishin shqiptarët. Së paku në intervistën që më dha mua dhe në bisedat në dy apo tri takimet që patëm, është deklaruar kështu.

Ndërkohë, në intervistë për mediat në Prishtinë, flet një regjisor dhe skenarist (Luan Kryeizu) i cili është duke i bërë përgaditjet për një film në lidhje me Adem Jasharin. Këtu thuhet se për rolin e Adem Jasharit qenka lajmëruar (vullnetarisht) Rade Šerbedžija. Kjo nuk është e konfirmuar, por po e marim se është e vërtetë.

Shihet se si regjisori ynë, me një 'nonchalance', të tepërt edhe për Hollywood, e refuzon kërkesën e Rade Šerbedžija-s. Arsyeja? Për shkak se Šerbedžija është serb! Pra, shkak i refuzimit nuk janë cilësitë artistike të aktorit por nacionaliteti i tij. Regjisori ynë, me anë të filmit të tij për heroin tonë, Adem Jasharin, dëshiron të krijoj patriotizëm e jo art.

Ky 'refuzim' flet shumë. Flet për gjendjen tonë në Kosovë por edhe për mardhëniet shqiptaro-serbe ku arti, humanizmi, politika, muzika dhe letërsia janë ende pjesë e luftës që tenton të mos përfundoj.

Dhe, PO. Poenta ime është që Rade Šerbedžija lirisht mund ta luaj rolin e Adem Jasharit. Arsyet PRO janë të shumta kurse 'arsyet' CONTRA janë të pakta.



• Aktori më i mirë mbështetës - Sam Rockwell - Three Billboards Outside Ebbing, Missouri



## “THE SHAPE OF WATER”

## FITON KATËR ÇMIME “OSKAR”



• Stilimi dhe Make up-i më i mirë - Darkest Hour - Kazuhiro Tsuji, David Malinowski & Lucy Sibbick



• Filmi më i mirë në gjuhë të huaj - A Fantastic Woman (Chile)



• Filmi më i mirë i animuar - Coco



• Dokumentari më i mirë - Icarus - Bryan Fogel dhe Dan Cogan



• Filmi më i mirë i animuar - Coco

Pas një spektakli dhe parakalimi mbi Tapetin e Kuq, mbrëmja gala e ndarjes së Çmimeve Oscars ka shpallur edhe fituesit e saj për çdo kategori. Ky ishte edicioni i 90-të i Oscar Awards, ceremonia e të cilit u mbajt në Dolby Thietër në Hollywood. “The Shape of Water” ka qenë filmi me më shumë Çmime Oscar të fituar në këtë edicion të 90, me plot 4 të tillë, përfshi filmin më të mirë dhe drejtorin më të mirë. “The Shape of Water”, është një film nga regjisorii Guillermo del Toro, që flet për një grua pastruese, e cila bie në dashuri me një krijesë të çuditshme të lumi. Gary Oldman fitoi Oscar si aktori më i mirë për rolin e tij si udhëheqësi britanik i kohës së luftës, Winston Churchill, në filimin “Darkest Hour”. Frances McDormand, ndërkaq, mori Oscar si aktoria më e mirë për rolin në filmin “Three Billboards Outside Ebbing, Misuri”. Oscari është çmimi më prestigjioz i industrisë së filmit.

Në përmbledhjen e mëposhtme, ju sjellim të gjithë fituesit në ceremoninë “Oscars 2018”.

- Skenari më i mirë origjinal:** Jordan Peele
- Skenari i përshtatur:** James Ivory (Call Me By Your Name)
- Aktorja më e mirë në rol dytësor:** Allison Janney (I, Tonya)
- Kostumografia:** Phantom Thread
- Dizajn prodhuesi:** The Shape of Water
- Makijazhi dhe stili flokëve:** Darkest Hour
- Kinematografia:** Blade Runner 2049 – Roger Deakins
- Editimi filmik:** Dunkirk
- Editimi i zërit:** Dunkirk
- Miksimi i zërit:** Dunkirk
- Efektet vizuale:** Blade Runner 2049
- Filmi i shkurtër i animuar:** Dear Basketball
- Filmi i animuar:** Coco
- Filmi i shkurtër dokumentar:** Heaven Is a Traffic Jam on the 405
- Filmi më i mirë dokumentar:** Icarus
- Filmi i shkurtër (live action):** The Silent Child
- Filmi i huaj më i mirë:** A Fantastic Woman (Kili)
- Aktori më i mirë në rol dytësor:** Sam Rockwell (Three Billboards Outside Ebbing, Missouri)
- Kolona zanore:** The Shape Water (Alexandre Desplat)
- Muzika – kënga origjinale:** Remember Me – Coco (Kristen Anderson-Lopez dhe Robert Lopez)
- Regjisori më i mirë:** Guillermo Del Toro (The Shape of Water)
- Aktorja më e mirë në rol kryesor:** Frances McDormand (Three Billboards Outside Ebbing, Missouri)
- Aktori më i mirë në rol kryesor:** Gary Oldman (Darkest Hour)
- Filmi më i mirë:** The Shape of Water

### MARYL STREEP PLOT TË 20 HERË E DOMINUAR PËR “OSCAR”

Shumë filma dhe aktorë të njohur janë nominuar edhe këtë vit në kategori të ndryshme, teksa ka disa prej tyre të cilët nuk e kanë prekur për herë të parë magjinë e nominimit në një çmim “Oscar”. Aktorja e njohur me famë botërore Meryl Streep është nominuar këtë vit për plot të 20-tën herë për çmimin “Oscars”. Streep është nominuar në kategorinë për rolin më të mirë femër për filmin “Florens Foster Jenkins”, film në të cilin kishte rolin e një gruaje të pasur. Ndër vite aktoria është nominuar gjithsej 16 herë për rolin kryesor femër, dhe katër herë të tjera për rolin dytësor.



## Përpyjekja për të mos rënë në moralizëm

Luljeta Lleshanaku është një nga penat më të njohura shqiptare të dekadave të fundit e ndoshta me përcjelljen më prestigjioze ndërkombëtare të këtyre viteve. Ndjenja më e mirë, kur largohesh nga takimi me një shkrimtar, është që të bëjë të mendosh. Dhe, më e adhurueshmja, që të kesh dëshirë ta ritakosh. Luljeta Lleshanaku t'i jep të dyja këto mundësi. Kuptohet, nëse do të dish të bësh një bisedë pa kurthet e zakonshme për të kapur gjëra sipërfaqësore, që sot bëjnë lajmin; nëse do të dish të kapësh te lat dhe mbi të gjitha duke ditur të futesh në thelbësitë e jetës. Luljeta Lleshanaku ka një formim të mirë, fryt i studimeve në institucione arsimore me reputacion anglo-sakson dhe mbi të gjitha sensin për të bërë sinteza të drejta dhe të qarta të mendimeve. Kjo duket në letërsinë e saj por edhe në artikullimet jo të shpesh-ta në median shqiptare, tashmë mbushur me lloj-lloj kinsesh. Autorja jonë asnjëherë nuk i jep të drejtë vetes për të shkruar atje ku nuk di. Ka një postulat krijimtarie, që duket se i përcakton disa vije krijimtarie: "Letërsia është një meditim për jetën, por bazuar mbi përvojën personale; thjesht trego atë që di. Tani, fjala vjen, do të doja shumë të kisha qenë në një rën prej atyre anijeve të eksodit të vitit 1991 në të cilën ndodhej një pjesë e familjes sime, për ta rrëfyer në një roman, por nuk kam qenë, dhe e kam të vështirë të improvizoj me imagjinatë atë që ndodhi aty". Për fat, ajo ka zbardhur edhe disa nga identitetet me të cilat përballlet. Një nga këto tema, që zbulohet rrallë në autorët tanë, të cilët u duhet të punojnë duke e modifikuar stilin dhe natyrën, thjesht për t'u bërë të kënaqshëm dhe të asimilueshëm për publikun. Krejt ndryshe, ajo tregon hapur identitete me të cilat përballlet në krijimtarinë e saj. Nga ana tjetër, ajo na rrëfen edhe një ekuilibër shumë delikat, që ka lidhje me përpjekjen për të mos rënë në moralizëm dhe në filozofinë boshë. "Nëse ia kam dalë, besoj se ka të bëjë me zgjedhjen e imazhit si mjet shprehës. Mjeshtëria është të dish të zgjedhësh subjektin, detajet, gjestet, të cilat flasin vetë; përndryshe rrezikon të përfundosh në koment ose deklamim. Them se më ka ndihmuar shumë filmi, piktura, fotografia, për abstragimin përmes imazhit", shprehet ajo.

Ben ANDONI



Luljeta Lleshanaku

## Njeriu pa tokë

### MESHKUJ

Qenia njerëzore është si një gjuhë e vdekur; prej saj mbetet vetëm një shprehje, citim, apo një fjalë e vetme. Por një baba pa djem është mutacion. Emri i tij do qarkullojë nga njëri vesh në tjetrin, përmes një fryme të pastër femërore i artikulluar si një ëndërr pa konflikt e vështirë për t'u mbajtur mend të nesërmen. Gjashtë vajza: secila prej lindjeve që një dështim si tregtari i arit që kthehet në shtëpi vetëm me mëndafsh dhe çajëra kurativë. Pa një djalë në familje pa një lumë për të derdhur mbeturinat toksike të zemërimit të tij bardhë e zi, Pa dikë për të parashikuar dimrat në skeletin e kafshëve të shtëpisë pas darke luftërat, lindjet, vdekjet kur jeta dembeloset në paqe.

Qeliza e tij është një shpellë me skica naive prej karboni gjahtari kundër bishes, gjahtari kundër natyrës deri në çastin kur një grua shfaqet afër zjarrit. atëherë fuqia zhvendoset nga muskujt tek sytë dhe kendi i shigjetës bëhet i paqartë.

Ky është fundi i epokës së akullit dhe fundi i qartesisë.

Dhe është një sekret që i përthith burrat nga brenda si Yjet Xhuxha duke i transformuar nga të verdhë, në të bardhë dhe pastaj të zinj, një njollë në kozmos. Pa një djalë për t'ia përcjellë këtë: jo sekretin në vetvete, por artin e vetmisë.

### MBI ÇATINË E TË ÇMENDURËS

Është punëtori i turnit të dytë që kthehet nga fabrika e konservave në mesnatë ai që hedh gurë mbi çatinë e gruas së çmendur.

Ajo i mallkon nga brenda pa destinacion "Ju, u shofshi ju, krijesa te ndyra!" kur ai teston atë pak fuqi që i ka mbetur përmbi tjegulla.

Është vetë historia- e paaftë për t'i drejtuar gishtin fajtorit në fytyrë, një çelës që hap të gjitha dyert, një mallkim në grup, në një natë kur ajri kundërmon sardele dhe enzima.

### NJERIU PA TOKË

Unë jam njeri pa tokë, gjithçka që kam është e shkruar pjerrtas në fytyrë një "fragile" mbi pakot e transportit midis festave.

Kurse gjyshi im merret e jepte me pronën e tij si bisha me grackën pa përfshirë një të tretë në sfidë.

Ishte duel xhentëlmenësh Lojë pa hile, pa befasi, me raunde të rregullta armëpushimi midis e pa plagë të vogla; ajo të merr të gjithin.

Hapat e tij ishin të mëdhenj. Shikimi një bimë mishëngrënëse një zonë e pastër nga insektet dhe dyshimet.

E kur toka që e para që e la ai pa tradhtinë e ndodhur ndërkohë pas shpinës së tij: se si mani hidhte hije mbi oborrin e fqinjët si e shoqja kishte hequr një çorape mllefi para se të vdiste dhe djemtë po i plakeshin pa u martuar.

Im gjysh nuk ndërtoi një kullë. Zgjedhi gjuhën horizontale për të folur me zotin: bleu tokë pafund. Bleu vazhdimësi dhe gjithësi blasfemoi kur i ishte thënë qartë: "ti nuk ke fuqi për të menduar (të mendosh) të nesërmen!"

Unë jam ndryshe; jam njeri pa tokë dhe asgjë nuk ndodh pas shpinës sime. unë jam gjithmonë në kohën e duhur - gazeta e lagur e ditës që i ngjitet të parit kamion që shkon rrugës.

### TË BURGOSURIT

Të burgosurit, të fajshëm e të pafajshëm kur dalin, kanë të gjithë të njëjtën shprehje në fytyrë - patriarkun a saporënë nga froni.

Kur kapërceu pragun ai përkuli kokën, pavarësisht gjatësisë së tij mesatare. Të njëjtën gjë bëjnë beduinët kur futen në tendën që kanë mbartur gjithë ditën mbi shpinë

Muret, perdet e pastra dhe aroma e gëlqeres ndjellin ndjesinë e luftës së ftohtë kur lufta sapo ka marrë fund.

Dhe të nesërmen çarçafët e tij u varën për ajrosje

në mes të oborrit, si pas natës së parë të dasmës, njollat e virgjërisë.

Fytyra të nxira nga dielli e rrethuan gjithë sy e veshë "Çëndërr pe mbrëmë?" Ëndrrat e të burgosurit janë pergamena që shenjtërohen prej kapitujve të humbur.

E motra, sapo i zbuloi një zakon të ri: copa të fshehura buke nëpër xhepa e nën shtrat dhe të pririt pa pushim dru për dimër.

Ç'ishte gjithë ky panik? Çfarë mund të ishte më e keqe se vitet e burgut?

E drejta për të zgjedhur Duke mos mundur.

### REALITETE VERTIKALE

Vazhdimësia, në rastin tim, nuk është zgjedhje por detyrim qëkur tri breza zgjohen njëherazi brenda meje.

I pari është një fëmijë i plakur; im atë. Fatin dhe veshjet i zgjedh gjithmone një numër më të vogël.

E pastaj gjyshi. Në kohën e tij nuk njihej fjala "diagnozë", ai thjesht vdiq nga dëshpërimi gjashtë muaj pas së shoqes E pa humbur kohë, mbi trupat e tyre komuniteti ndërtoi një punishte uniformash prej doku.

E stergjyshit, nëse ka ekzistuar një i tillë, unë nuk ia di as emrin, këtu kujtesa pëson hiatus, - prejardhja fshatare e prerë si thonjtë e fortë e të zverdhur nga puna ne arë.

Te tre perkulen si një pyll sipër meje e më diktojnë se çfarë duhet të bëj e çfarë nuk duhet.

Sapo dëgjove prej meje një të tillë "mirëmëngjes" si e dalë prej një elefanti me putra mbi piano apo prej shqepjeve të xhakëtës së tim eti.

Ata nuk po orvaten të ndryshojnë ndonjë gjë e as të kundërvihen; ndjehen të freskët ashtu të larë me sapunin e lirë të perkohësisë.

Thjesht e riprekin botën përmes meje si me një palë doreza plastike për të ruajtur të pastër shkakun. në vendin e krimin.

## “Ura në mjegull”, sjell historinë e dy vajzave 12-vjeçare

“Ura në mjegull”, ky romani i ri i Muriel Barbery-t është një inkursion në zhanrin e realizmit magjik. Ai sjell historinë e dy vajzave 12-vjeçare të rritura në Francë dhe në Itali, të cilat zbulojnë njëkohësisht një botë të fshehtë elfësh.

Çfarë kanë të përbashkët vogëlushja Maria, e cila jeton në një fshat të thellë të Burgonjës, dhe një tjetër vajzë e vogël, Klara, e cila rritet në Abrucio të Italisë në të njëjtën kohë me Marian dhe që më pas dërgohet në Romë për të zhvilluar talentin e saj të jashtëzakonshëm për muzikën? Në dukje, pak gjëra. Megjithatë, mes tyre ekziston një lidhje sekrete: secila me mënyra të ndryshme është në kontakt me botën e elfëve, me botën e artit, të shpikjes, të miste-



rit; gjithashtu edhe me atë të osmozës me natyrën, që u jep jetës së njerëzve thellësinë dhe bukurinë e saj. Mirëpo, një kërcënim i madh nga një elf batakçi rëndon

mbi racën njerëzore dhe, vetëm Maria dhe Klara janë në gjendje që, përmes bashkimit të dhuntive të tyre, të prishin planet e tij. Dy vogëlusheve, pasi bashkojnë forcat, do t'u duhet të zhvillojnë një betejë të gjatë.

Libër i çuditshëm: një luftë, një piano dhe shumë kafshë magjike në botën e elfëve, që zbulojnë dy vogëlushet protagoniste. Një tjetër histori e mrekullueshme, elegante dhe që të jep kënaqësi për dashurinë, për fuqinë e rrëfimit dhe për lidhjet mes natyrës dhe njeriut.

MURIEL BARBERY është romanciere dhe mësuese filozofie franceze. Lindi më 28 maj 1969 në Kazablanka të Marokut, por bashkë me prindërit u shpërngulën

në Francë kur ajo ishte vetëm dy-muajshe. Studioi në Liceun Lakanal, ndoqi studimet në Ecole Normale Supérieure të Fontenay-Saint-Cloud-it në vitin 1990 dhe u diplomua për filozofi në vitin 1993. Më pas ajo dha filozofi në Universitetin e Burgonjës dhe në Saint-Lô IUFM (kolegji për trajnimin e mësuesve). Pasi e la punën, jetoi për dy vjet në Japoni (2008-2009). Aktualisht jeton në Evropë.

Romani i saj “Eleganca e iriqit” (botuar në shqip nga shtëpia botuese “Dudaj”) kryesoi listat e librave më të shitur francezë për 30 javë radhazi dhe u ribotua 50 herë. Ky libër i saj ka qenë bestseller në Francë, në Itali, në Gjermani, në Spanjë, në Korenë e Jugut dhe në shumë vende të tjera.



## “Lumturitë e papërfillshme” të Piccolo-s e kanë zanafillën tek arti i vetëpranimit

A mund të ekzistojnë lumturi të papërfillshme? E si mund t'i quash ndryshe ato kënaqësi të thekshme e ikanakë që shënjojnë ditët tona, duke përflakur minutat si fijet e shkrepëve në errësirë? Me shkreptima rrufeje, fshkullima kamxhiku dhe histori, Francesco Piccolo nxjerr cullak me një humorizëm të pamëshirë vetëtimat më verbuese të ngazëllimit, regëtimat, të fshehtat e strukura në skutat më të thella me të cilat herë a vonë të gjithë duhet të përballlemi. Faqe pas faqeje, çast pas çasti, përfshihesh nga një shkullm i pandalshëm hareje, inteligjence dhe çmeritjeje. Pas suksesit të madh që korri “Çaste lumturie të papërfillshme”, Francesco Piccolo kthehet të tregojë ngazëllimin e çasteve që përbëjnë jetën, vetëm se këtë radhë orvatet t'i shohë nga ana e gabuar. Duke i qëmtuar me kujdes ditët derisa zbulon se si në çdo kleçkë të beftë që të ndodh, qoftë edhe më e bezdisshme, fshihet diçka e paçmuar: një shkëndijë sflitëse zbavitjeje dhe vitaliteti. Secili prej nesh provon gjatë ditës një mijë e një formë të papërfillshme (dhe jo të parëndësishme) trishtimi. Por të lind dyshimi që është “si shkopinj të shangait”: nëse do të tërhiqja gjënë që më pëlqen më pak nga njeriu që dua, do të rrezohej edhe ajo që më pëlqen më shumë.

Dhe askush s'di ta rrefejë më mirë se Francesco Piccolo, i cili me çastet që e përbëjnë jetën krijon një enciklopedi finoke e fort zbavitëse që mund ta marrësh me vete gjithkund. FRANCESCO PICCOLO jeton dhe punon në Romë. Për Einaudi-n ka botuar: “Ndarja e mashkullit” (2008), “Histori parëlindurish dhe fëmijësh të vetëm” (2012), “Perëndimor gazmor” (2013) dhe “Dëshira për të qenë si të gjithë” (2013). Francesco Piccolo ka fituar Çmimin Strega 2014 me “Dëshira për të qenë si të gjithë”.

## Romanovet 1613 - 1918, Simon Sebag Montefiore

Libër rrëmbyes... Historia e Romanovëve është shkruar shumë herë, por asnjëherë me një kombinim të tillë kaq tërheqës të shijes letrare, fuqisë treguese, kërkimeve ngulmuese dhe depërtimeve psikologjike.

Romanovët kanë qenë dinastia më e suksesshme e kohëve moderne, duke sunduar një të gjashtënë e sipërfaqes së botës. Si arriti një familje mbretërore të shndërronte një principatë të rrënuar nga lufta në një nga perandoritë më të mëdha të botës? Dhe si e humbi pastaj krejt atë? Kjo është historia e vërtetë e dymbëdhjetë carëve dhe careshave, disa të karakterizuar nga gjenialiteti, disa nga çmenduria, por të gjithë të frymëzuar nga autokracia e shenjtë dhe ambicia perandorake.

Kjo kronikë tejet rrëmbyese e Montefiores nxjerr në pah botën e tyre të fshehtë për një etje të pakufishme për pushtet dhe për ndërtimin e një perandorie të pamëshirshme. Ajo është një botë e mbushur me konspiracione të oborrit mbretë-



ror, rivalitete familjare, dekadencë seksuale dhe ekstravagancë të egër, me një kastë aventurierësh, kurtizanesh, revolucionarësh dhe poetësh nga Ivani i Tmerrshëm deri te Tolstoi, nga mbretëresha Viktoria deri te Lenini.

Sundimi i Rusisë ka qenë sa një mision i shenjtë perandorak, aq edhe një kupë e helmatisur: gjashtë carë janë vranë me atentate. Pjetri i Madh torturoi djalin e vet deri në vdekje, ndërkohë

që po e bënte Rusinë perandori dhe po e dominonte oborrin e tij si një klub që kishte marrë nam për dehjet e detyruara, xhuxhët lakuriqë dhe veshjet luksoze. Katerina e Madhe rrëzoi nga pushteti të shoqin – që shpejt pas kësaj u vra – u dashurua me favoritët e saj meshkuj rioshë, pushtoi Ukrainën dhe magjepsi Europën.

Pavlin I e mbyti me duar i biri, Aleksandri I, i cili u përball me pushtimin e Napoleonit dhe me djegien e Moskës dhe vijoi me pushtimin e Parisit.

Aleksandri I çliroi bujkrobërit, u mbijetoi pesë atentateve dhe shkroi letrat e dashurisë më të spikatura që mund të jenë shkruar ndonjëherë nga ndonjë sundimtar.

Libri “Romanovët” mbërrin kulmin e vet me një portretizim të freskët dhe të paharrueshëm të Nikollait dhe Aleksandrës, të ngritjes dhe të vrasjes së Rasputinit – dhe masakrës së përbindshme të të gjithë familjes perandorake.



## Elefanti zhduket, Haruki Murakami

“Elefanti zhduket” është një tufë rrëfenjash fine, në stilin e njohur postmodern të Haruki Murakamit, ku shfaqen të gjitha nuancat kulturore japoneze që e dominojnë prozën e këtij autori, por edhe shenjat universale të kohës sonë të endura nëpër gjeografinë e gjerë të fantazisë së tij.

Si një mjeshtër i adhuruar për ndërtimin e personazheve aq të besueshëm, ai na dizajnon profile të çuditshëm dhe mahnitës karakteresh, të cilët, përmes grimcave të jetës së tyre të përditshme, duken sa të ngjashëm mes vedi, aq edhe bartës të unit të tyre dallues. Fuqia e tij narrative, u jep mundësinë këtyre personazheve të vetërrëfihen për familjen, karrierën, dashurinë, vdekjen, miqësitë, të njohurit e të huajt që janë pjesë e jetës së tyre, duke bartur në rrëfime dhe filozofinë e tyre personale, e që ashtu bashkë, i japin lexuesit një ngrehinë mahnitëse të populluar nga qenie reale dhe surreale, siç vetëm Murakami di të na i dhurojë. Pas suksesit në shqip të një sërë romanesh, ky vëllim me proza të shkurtër, i paraqet lexuesit shqiptar një dimension tjetër mjeshtëror të këtij autori të adhuruar nga miliona lexues në botë.

## Monografi mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave


Libri “Shqipëria dhe Jugosllavia (1945–1948)” i dr. Ledion Krisafit, për herë të parë në mënyrë shkencore e plotësisht të argumentuar, sfidon “mite” të ngritura në paradigmen e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Me këtë monografi, autori mund të radhitet në grupin e studiuesve që, duke u mbështetur në të dhëna burimore të të dy palëve (shqiptare dhe jugosllave), arrin në përfundime origjinale, larg të qëndruarit “bardh e zi”.

Libri synon, gjithashtu, që për herë të parë të hapë edhe

këndvështrimin jugosllav mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të lexuesit shqiptar. Studiimi i këtyre të dhënave të nxjerra nga autori nga arkivat e ish-Jugosllavisë në Beograd, jo vetëm që hedhin dritë të re mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të asaj periudhe, por riinterpretojnë politikën e jashtme të Shqipërisë në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore dhe qëllimin e Enver Hoxhës në politikën e jashtme jo vetëm në lidhje me Jugosllavinë, por edhe me Bashkimin Sovjetik.

Libri është shkruar plot realizëm e pasion. Libri do të jetë



një ndihmesë e çmuar në historiografinë tonë.

# PAPUNËSIA NË KOSOVË, PROBLEM "KRONIK"

Papunësia në Kosovë, sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës ka arritur në mbi 30 për qind. Sipas këtyre të dhënave - papunësia është më e theksuar te femrat me 38 për qind, krahasuar me meshkujt, 27.8 për qind. Derisa, shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeç dhe atë mbi 50 për qind

Valon Maloku 25-vjeç nga Fushë Kosova, i diplomuar në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës thotë se asnjëherë nuk ka qenë i punësuar. "Tani dy vjet jam në kërkim të një pune. Gati çdo konkurs që shoh dhe përshtatet me përgatitjet e mia aplikoj, por në shume raste as në intervistë nuk jam ftuar. Te jesh i papunë në Kosovë është vështirë. Gjithë koha më kalon nëpër kafene. Problemi me i madh janë financat kur je i papunë. Duhet të varesh nga të



tjerët". "Je barre për familjen e për të gjithë. Në këtë rast mendja të shkon të ikësh nga ky vend. Por, prapë shpresoj që bëhet mirë. Institucionet e vendit duhet të jenë të vëmendshëm dhe ta dinë këtë çfarë po ndodh, të bëjnë diçka në zhvillimin ekonomik të vendit", thotë Valoni. Papunësia në Kosovë, sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës ka arritur në mbi 30 për qind. Sipas këtyre të dhënave - papunësia është më e theksuar te femrat me 38 për qind, krahasuar me meshkujt, 27.8 për qind. Derisa, shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeç dhe atë mbi 50 për qind.

Ndërkohë në tregun e punës në Kosovë, në vit janë aktivë për t'u punësuar deri në 25 mijë persona, të gjithë të gjeneratës 18-vjeç e më lart, derisa po ky treg mund të absorbojë as 10 mijë punëtorë në vit. Të shtyrë nga papunësia, shumë qytetarë të Kosovës, kryesisht të rinj, patën migruar ilegalisht në Evropën Perëndimore gjatë nëntorit 2014 deri në qershor të 2015-s. Niveli i papunësisë deri mbi 30 për qind konsiderohet të jetë alarmante për një vend si Kosova, e cila konsiderohet të ketë potencial për zhvillim ekonomik.

Kosova brenda vitesh, thuhet nga ekspertë të fushës, nuk ka arritur që të krijojë një ekonomi më

të zhvilluar, për shkak të nivelit të ulët të investimeve të huaja, politikave jo të mira fiskale si dhe nivelit të lartë të korrupsionit. Eksperti i çështjeve ekonomike Ismajl Kastrati thotë për Radion Evropa e Lirë se me këtë ritëm të zhvillimit nuk mund të pritë zbutja e nivelit të papunësisë në Kosovë. "Papunësia në Kosovë është kronike, diku edhe para luftës shkalla e papunësisë ka qenë 40 për qind. Së fundmi ka rënë shkalla e papunësisë, por jo se është rritur numri i të punësuarve brenda, por për shkak se një numri i madh i punëtorëve emigrojnë jashtë vendit. Shkaqet e papunësisë është ritmi i ngadalshëm i zhvillimit ekonomik për

shkak se mungojnë investimet e jashtme, investitorët e jashtëm hezitojnë të vijnë në Kosovë për shkak se ka krim të organizuar, korrupsion dhe nuk funksionon rendi dhe ligji", thotë Kastrati. Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit Agim Shahini në një prononcim për Radion Evropa e Lirë thotë se papunësia mbetet një nga problemet më të mëdha në Kosovë, por që pavarësisht kësaj, siç thotë Shahini, Qeveria vazhdon të mos e trajtojë me prioritet këtë problem.

"Për të luftuar papunësinë duhet të krijohet hapësirë për zhvillim ekonomik. Vendi po vuan për shkak të imazhit të keq politikave jo të mira, korrupsionit burokracisë dhe ikjes së investitorëve të huaj, ku sipas rezultate vendore dhe ndërkombëtare, Kosova duhet të ketë prioritet zhvillimin ekonomik të vendit", thekson Shahini. Autoritetet në Kosovë vazhdimisht kanë deklaruar se janë të vetëdijshëm për nivelin e lartë të papunësisë dhe se për këtë Qeveria e Kosovës prioritet kryesor ka vënë zhvillimin ekonomik të vendit.

Por, pavarësisht vënies në prioritet të zhvillimit ekonomik dhe rrjedhimisht hapjen e vendeve të reja të punës, papunësia vazhdon të mbetet e lartë për vite me radhë, derisa rritja ekonomike në Kosovë përgjatë viteve nuk ka qenë më e lartë se 4 për qind.

(REL)

## Kosovë, 10 mijë lindje më pak për shtatë vite

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitin 2010 janë regjistruar gjithsej 33.966 lindje, kurse në vitin 2016 janë evidentuar 23.494 lindje

Kosova gjithmonë ka qenë në krye të listave në Evropë sa i përket lindshmërisë. Por, numri i lindjeve në shtatë vitet e fundit ka shënuar rënie për më shumë se 10 mijë lindje më pak, ndërsa. E faktorët kryesorë të rënies së natalitetit në Kosovë janë kushtet e vështira ekonomike, ligji i lehonisë, planifikimi familjar, si dhe emancipimi i femrës. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitin 2010 janë regjistruar gjithsej 33.966 lindje, kurse në vitin 2016 janë evidentuar 23.494 lindje. Kurse, vetëm në Klinikën e Gjinekologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në vitin 2016 janë regjistruar 10 mijë e 139 lindje, ndërsa për vitin 2017 janë regjistruar 10 mijë e 161, kurse në dy muajt e parë të vitit 2018 janë regjistruar rreth 1 mijë e 442 lindje, shkrua koha.net. Drejtoresha e Klinikës



së Gjinekologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Myrvete Paçarada rënien e natalitetit në Kosovë e arsyeton me faktin se femrat në Kosovë po i përkushtojnë më shumë karrierës. Ajo ligjin e lehonisë në Kosovë dhe planifikimin familjar i sheh si faktorë që po ndikojnë në rënien e natalitetit në vend. "Një problem tjetër që është dukuri është se pushimi i lehonisë tek nënat, është shumë i shkurt. Ajo detyrohet ta lë fëmijën e vogël

për ta vazhduar punën e vetë sepe e humb kontratën, e humb vendin e punës...Edhe planifikimi më i mirë familjar që dita ditës po vërehet në gjeneratat e reja me kontraktiv me planifikim të mirëfilltë familjar, domethënë edhe ajo po ndikon që po bëhet një planifikim më i mirë, më i arsyeshëm...nuk do të thotë mos me bë fëmijë por do të thotë me bë fëmijë kur janë kushtet të favorshme për fëmijën, për prindin. Fëmija duhet të jetë i plani-

fikuar jo të jetë pasoj e një jo kontrole", shtoi ajo. Sipas saj, rënia e lindjeve mund të merrret edhe si trend pozitiv nëse është e planifikuar. "Në një mënyrë edhe rënia e numrit mund të merrret edhe si trend pozitiv nëse është e planifikuar, nëse kemi këtë ngritje intelektuale të vajzat tona, por në mënyrën tjetër Kosova kurrë nuk ka mjaftë fëmijë, ne kemi nevojë për fëmijë dhe iu apeloj të rinjë që të lindin sa më tepër fëmijë", tha ai.

## Presion mbi Beogradin për demarkacionin me Malin e Zi

Partitë në pushtet janë në pritje të përgjigjes nga deputetët e Listës Serbe, në përpjekjen e katërt për ta ratifikuar demarkacionin. Ato nuk kanë treguar nëse janë krijuar rrethanat që demarkacioni përfundimisht të votohet këtë javë. Kjo për shkak të mungesës së edhe dy votave, në mënyrë që të arrihen dy të tretat aq sa duhen për t'i ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare. Buri me të gazetës kanë thënë se partitë në pushtet janë duke pritur konfirmimin e Listës Serbe, i cili deri më tani ka munguar për shkak zhvillimeve në Beograd, ku të dielën u votua për zgjedhjet lokale. Sipas burimeve, gjatë javës pritet të ketë lëvizje pozitive me Listën Serbe, "ngase ka edhe presion ndërkombëtar në Beogradin zyrtar për votimin e demarkacionit". Kërkesa kryesore e Listës Serbe mbetet themelimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe, "pa vonesa të mëtejme", gjë për cilën është diskutuar edhe në takimin e fundit në Bruksel mes Kosovës dhe Serbisë.



## Euroskeptikët triumfojnë në Itali

Triumfi i populistëve euroskeptikë në Itali. Lëvizja 5 Yjet ka siguruar shumicën e votave në zgjedhjet e së dielës me mbi 31%. Ndërsa si koalicion kryesor qendra e djathtë. Por partia më e madhe e këtij spektri nuk është më Forca Italia e Silvio Berlusconi, por nacionalistët e Lega Nord, që në rang kombëtar renditen të tretët me mbi 18%. Rezultatet tepër i dobët për demokratët e qendrës së majtë të Mateo Renzi që kanë marrë rreth 19% të votave. Asnjë prej partive pritet të mos e sigurojë shumicën qeverisëse, teksa numërimi i votave vijon. Analistët nuk përjashtojnë një koalicion pas-zgjedhor mes euroskeptikëve të Lëvizjes 5 yjet dhe Lega Nordit. Kombinimi i parashikuar më herët mes Demokratëve dhe Forca Italias së Berlusconi, duket se nuk e krijon dot qeverinë.

## Arabia Saudite, gratë për herë të parë në gara atletike



Gratë në Arabinë Saudite kanë marrë pjesë për herë të parë në garën atletike në historinë e mbretërisë. Gara në gjatësi prej tre kilometrave është mbajtur në provincën lindore Al-Asha. Në garën ndërkombëtare me titull "Al-Asha Runs" morën pjesë rreth 1.500 gra në kategori të ndryshme të moshave, në konkurrencë amatore dhe profesionale. Drejtorja e përgjithshme për sport e Arabisë Saudite, spitali Al-Moosa dhe komuna Al-Asha ishin sponsorë të garës. Fituese e garës ishte Mizna al-Nassar nga Arabia Saudite.

## Të paktën 950 sulme kundër myslimanëve në Gjermani

Autoritetet gjermane regjistruan të paktën 950 sulme ndaj myslimanëve dhe institucioneve myslimane, si xhamitë, në vitin 2017, sipas të dhënave nga Ministria Gjermane e Brendshme. Ministria tha se 33 vetë u plagosën në këto sulme. Gjashtë sulme u kryen në xhami, ku gjaku i derrave ishte përdorur gjithashtu. Pothuajse të gjithë ata që ishin përgjegjës për sulmet ishin ekstremistë të krahut të djathtë, sipas të dhënave, raportojnë mediat gjermane.



# MASAKËR NË GUTA,

# ASADI TALLET ME BOTËN

Rreth 720 civilë janë vrarë si pasojë e bombardimeve në 10 ditët e fundit, më shumë se 200 prej tyre janë fëmijë. Fatkeqësisht bilanci i viktimave pritet të jetë edhe më i rëndë, pasi sulmet ajrore nga forcat qeveritare dhe aleatët e tyre rusë nuk janë ndalur për asnjë moment

Masakra njerëzore në Gutan Lindore, pranë kryeqyteti sirian Damask, rrezikon të ketë të njëjtin fund me Aleppon. Rreth 720 civilë janë vrarë si pasojë e bombardimeve në 10 ditët e fundit, më shumë se 200 prej tyre janë fëmijë. Fatkeqësisht bilanci i viktimave pritet të jetë edhe më i rëndë, pasi sulmet ajrore nga forcat qeveritare dhe aleatët e tyre rusë nuk janë ndalur për asnjë moment.

Të ashtuquajturit korridore humanitare që lihen për largimin e popullsisë nga zonat e luftës, bombardohen nga regjimi i Asadit, duke e shndërruar Gutan në një ferr të vërtetë për civilët. Zyr-

tarët për të drejtat e njeriut në OKB, kanë kërkuar që Siria të hetohet për në Cjkatën ndërkombëtare për krim kundër njerëzimit. Shtetet e Bashkuara ndërkohë akuzuan Moskën për bashkëpunim "brutal" në vrasjen e civilëve në enklavën Guta Lindore të Sirisë, duke thënë se avionët rusë hedhin bomba në kundërshtim me armëpushimin e Kombeve të Bashkuara. Komentet e Shtëpisë së Bardhë janë ndër më të ashprat drejtuar Moskës për mbështetjen e Qeverisë së presidentit Bashar al-Assad, gjatë shtatë vjetëve luftë në Siri. "SHBA dënon ofensivën e vazhdueshme ushtarake që regjimi i Assadit, i mbështetur nga Rusia dhe Irani, po kryen kundër popullit në Gutan Lindore", tha Shtëpia e Bardhë.

Në deklaratë thuhet se avionët ushtarakë rusë janë nisur nga aerodromi Humajmim në Siri dhe kanë kryer së paku 20 misione bombarduese në ditë pranë Damaskut dhe në Guta, në periudhën 24-28 shkurt. "Rusia ka vazhduar të injorëjë kushtet e armëpushimit të OKB-së dhe të vrasë civilë nën maskën e rreme të operacioneve kundër terrorizmit", thuhet në deklaratën e Shtëpisë së Bardhë. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dhe kryeministrja britanike, Theresa May, u dakor-

duan gjatë një bisede telefonike se Qeveria siriane dhe mbështetësit e saj rusë mbajnë përgjegjësi për "vuajtjet zemërtëhyera njerëzore" në Guta, bëri të ditur kabineti i kryeministres May.

Assad, në anën tjetër, tha se forcat e tij do të vazhdojnë me ofensivën kundër rebelëve në Gutan Lindore, pavarësisht thirrjeve të komunitetit ndërkombëtar për t'i dhënë fund asaj. Ai i bëri këto komente në televizionin shtetëror, derisa ushtria siriane duket se ka avancuar në disa fronte në operacionin e saj për të marrë kontrollin e Gutas nga rebelët. As "armëpushimi humanitar" i urdhëruar nga Moska, aleati kryesor i Sirisë, as thirrja e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për armëpushim 30-ditësh mbarëkombëtar nuk kanë çuar në asnjë ndihmë humanitare për enklavën e goditur, ku janë të bllokuar rreth 393.000 njerëz. Rusia, së bashku me Iranin, i kanë dhënë Qeverisë së Assadit mbështetje të rëndësishme gjatë gjithë luftës, e cila ka nisur me goditjen e qeverisë mbi protestat paqësore.

Moska ka ndihmuar në kthimin e konfliktit në favor të Assadit, duke nisur fushatën e sulmeve ajrore në vitin 2015 dhe duke rritur praninë e saj ushtarake në terren.

## Avionët izraelite helmojnë fushat bujqësore në Gaza

Forcat izraelite sot hodhën herbicide në fushat bujqësore palestineze përgjatë Rripit kufitar të Gazës. "Hedhja e kimikateve ka shkakuar dëme të mëdha në kulturat bujqësore dhe pronën", tha për AA, Nizar al-Wahedi, zyrtar i Ministrisë palestineze të Bujqësisë. Duke theksuar se Izraeli nuk ka të drejtë të hedhë herbicide në fu-

shat bujqësore palestineze, Al Wahedi, tha se Ministria palestineze e Bujqësisë ende nuk e ka të njohur përbërjen e kimikateve të cilin avionët izraelitë sot në mëngjes e kanë hedhur mbi fushat. Nga ana tjetër, organizata jo-qeveritare izraelite Gisha lajmëron se qëllimi i shpërndarjes së herbicideve përgjatë kufirit me

Gazën është bërë me qëllim të shkatërrimit të barit të panevojshëm dhe barërat e këqija në atë rajon. Së paku 44.000 palestinezë merren me bujqësi, që është rreth 11 për qind nga fuqia e përgjithshme e punës në këtë rajon. Izraeli nga viti 2007 nën bllokadë të plotë mban Rripin e Gazës në Palestinë.





MAQEDONIA FITON TURNIRIN NË FUTSALL "ADEM JASHARI"

# ISMAILI, LOJTARI MË I MIRË I TURNIRIT

Shkup, 5 mars - Përfaqësuesja e Maqedonisë e ka fituar turnirin "Adem Jashari" në futsal, pasi që në finale mundi Kombëtaren e Shqipërisë me rezultat 8-7, pas ekzekutimit të penalltive, pasi që koha e rregullt u mbyll baras (3-3), derisa edhe vazhdimet u mbyllën baras 5-5. Finalja mes kuqezinjve dhe ekipit verdhekuq ka prodhuar një ndeshje dramatike, me shumë gola e me shumë kthesa në rezultat. Kuqezinjtë e nisën mirë lojën dhe vetëm pas katër minutave e zhbllokoi ndeshjen përmes Hasajt, duke kaluar Shqipërinë në epërsi. Mirëpo, në minutën e 12-të Maqedonia u kthye në lojë përmes Leveskit, i cili barazoi shifrat në 1-1. Tre minuta më vonë, Maqedonia kaloi në avantazh me golin e Ylber Alilit, rezultat më të cilin skuadrat shkuan në pushim. Lojë dinamike është luajtur edhe në fraksionin e dytë. Pas gjashtë minutave të kësaj pjesë, skuadra shqiptare me golin e Agon Ramadanit barazoi rezultatin në 2-2. Por, sërish në epërsi vijën verdhekuq, kësaj herë me golin e Taulant Ismailit. Shqipëria nuk u dorëzua dhe në finish të ndeshjes përmes Narcis Alibegut barazoi



"Finalja ishte më së e vështirë, sepse Shqipëria ka lojtarë mjaft kualitative, të cilët luajnë në liga të fortë, kemi edhe shokë që luajmë në një ekip pasi që unë jam lojtar i Feniksit, ndihem i lumtur. Kupa 'Adem Jashari' për mua është shumë e vlefshme edhe pse luajë për Maqedoninë, unë jam shqiptar 100 për qind", është shprehur Ismaili

edhe një herë rezultatin në 3-3, rezultat më të cilën edhe u mbyll koha e rregullt. Drama e kësaj finale u zhvillua në lojën shtesë, dy herë nga pesë minuta. Futbollistët e Shqipërisë në lojën shtesë, krijuan epërsinë prej 5-3, më një gol të Selmanajt e Alibegut,

megjithatë, ekipi i Maqedonisë më angazhim maksimal ia doli që ta barazoj rezultatin në 5-5, më ane të Milenkovskit e Alilit, madje, ky i fundit shënoi në sekondën e fundit të ndeshjes, kështu që fituesi i kësaj finale të madhe u përcaktua pas ekzekutimit të penalltive. Nga

pika e bardh më e suksesshme u tregua Maqedonia duke fituar ndeshjen me rezultat të përgjithshëm 8-7. Ndryshe, Futbollisti i Maqedonisë, Taulant Ismaili, i cili u zgjodh edhe lojtari më i mirë i turnirit, i tha "Kosovapressit" se është i lumtur që ka fituar Kupën "Adem

Jashari". Sipas tij, finalja ishte një ndeshje e fortë, sepse në ekipin shqiptar luajnë lojtarë kualitativë, të cilët luajnë në ligat e mëdha. Ismaili tha se Kupa "Adem Jashari" për të është e veçantë. "Finalja ishte më së e vështirë, sepse Shqipëria ka lojtarë mjaft kualitative, të cilët luajnë në liga të fortë, kemi edhe shokë që luajmë në një ekip pasi që unë jam lojtar i Feniksit, ndihem i lumtur. Kupa 'Adem Jashari' për mua është shumë e vlefshme edhe pse luajë për Maqedoninë, unë jam shqiptar 100 për qind", është shprehur Ismaili.

Ndërkaq, në ndeshjen për vendin e tretë mes përfaqësueses së Kosovës A dhe Kosovës U-21, fitues doli Kosova A, me rezultat 6-5 pas ekzekutimit të penalltive, pasi që edhe në këtë takim koha e rregullt u mbyll baras 3-3. Në fund organizatorët e turnirit të nëntë ndërkombëtar "Adem Jashari" shpërblyen më të mirët e këtij eventit sportiv. Lojtari më i mirë i turnirit u zgjodh Taulant Ismaili (Maqedoni), portieri më i mirë Zoran Petrovski (Maqedoni). Vendi i parë, i dyti dhe i treti u shpërblyen me kupa dhe medalje.

## Demiri asiston në fitoren e Mariupol

Shkup, 5 mars - Besir Demiri i cili po luan tek skuadra e Mariupol, sërish ka parë veten në ekipin e javës në kampionatin e Ukrainës. Ai në fitoren minimale të skuadrës së tij Mariupol 1:0 ndaj Olimpik, pati një paraqitje të shkëlqyeshme dhe për këtë nga mediat ukrainase u rendit në ekipin e javës. Kështu pozita e mbrojtësit të majtë në ekipin ideal edhe këtë radhe ishte e rezervuar për shkupjanin Demiri. Ndryshe, në minutën e 29 të ndeshjes me Olimpik Donetsk, Demiri bëri një sllallom të vërtetë dhe më pas ky aksion përfundoi me gol. "Ishte kjo paraqitja ime të cilën e prisja një kohë të gjatë që nga ardhja ime në Mariupol. Do doja të kem paraqitje të tilla edhe në të ardhmen. Çdo gjë po shkon si duhet, ashtu që besimin e marrë nga trajneri jam duke e arsyetuar në maksimum", tha për "Alsat-M" Demiri. Gjithsesi Pas kësaj fitore Mariupol ngjitet në pozitën e gjashtë (32 pikë) dhe ka gjasa të sigurojë kualifikim në Liga Evropë.



ASGJË SERIOZE ME ARMANDO SADIKUN

## Rikthehet ndaj Gironas

Armando Sadiku ishte i ftuari special i "Zona Gol", ku shpjegoi me detaje atë që kishte përjetuar pas përplasjes me portierin Diego Lopez në takimin Levante-Espanjol 1-1. Sulmuesi i Kombëtares Shqiptare, në takimin e dytë me ekipin spanjoll ka pësuar një frakturë në hundë. "Ishte si një bombë, nuk e prisja fare që do të dilte portieri dhe u përplasëm kokë më kokë. Ai ka pësuar një çarje te veshi dhe një frakturë kocke afër veshit, ndërsa unë një frakturë në hundë. Doktorin ma vendosi në vend, por duhet t'i nënshtrohem një operacioni të vogël, nuk ka asgjë serioze. Do ta mbaj në allçi për dy ditë, të mërkurën pasdite dal në stërvitje me ekipin", u shpreh sulmuesi shqiptar. Ai u dëmtua në fund të pjesës së parë, ndërsa para se të niste e dytë trajneri vendosi ta zëvendësonte. "Doja të luaja në pjesën e dytë, por doktori më bëri pyetje dhe teste dhe e panë që nuk isha shumë i vetëdijshëm. Ishte moment që kisha shumë dëshirë të luaja, më ishte dhënë mundësia. Kam vënë maskën që sot dhe pres të jem gati që për fundjavën e ardhshme në Girona", vazhdoi



më tej Sadiku. Ndryshe, ambienti te Levante është i trazuar, sepse drejtuesit e klubit shkarkuan për rezultate të dobëta trajnerin Muniz. "Na përshëndeti në dhomat e zhevshjes. Kanë vënë një trajner të ekipit të të rinjve, shpresojmë të na sjellë një frymë të re. Cilësia e grupit është shumë e mirë. Shpresojmë të arrijmë rezultate pozitive, sot pësuam gol në minutën e fundit. Ky është një moment pak negativ, por duke qenë në ekip besoj se kemi shumë kualitet dhe na mungon

një fitore dhe çlirohemi". Sadikut iu desh të priste disa ndeshje për të debutuar me Levanten. Arsyet pse vonoi debutimi i tij lidhen me problemet fizike. "Që kur kam ardhur këtu, kam pasur dëmtime të vogla që më kanë lënë jashtë. Sa u rriafësova, u dëmtova sërish. Tani shpresoj që ky të jetë dëmtimi i fundit dhe të kthehem e t'i luaj të gjitha ndeshjet si titullar". Sadiku e pranon se ka marrë një risk përsipër ku pranoi transferimin nga Legia te Levante, që militon në një prej kampionate-

ve më të forta në botë. "Po nuk rrezikove, nuk fiton, më donin edhe në Turqi. Legia bleu lojtarë të tjerë po kishte vështirësi ekonomike. Erdhi një ofertë e mirë për klubin dhe për mua. U lëm e folëm bashkë dhe menduam që do të ishte zgjidhja më e mirë për të dy palët. Si mund ta refuzoja kampionatin spanjoll? Është ndër më të fortët në botë. Levante është në zonën e rënies, por mendoj që kemi shumë kualitet. Shpresoj të kaloj një kohë të mirë këtu", përfundoi Sadiku.





LIGA E KAMPIONËVE, NDESHJET KTHYESE TË 1/8 SË FINALES

# PSZH SHPRESON NË PËRMBYSSJE

Parisi ka shumë punë për të bërë që t'ia dalë mbanë kundër madrilenëve, pasi është mposhtur 3-1 në ndeshjen e parë të luajtur në "Bernabeu"

Paris Sen Zhermeni sonte (e martë) do të tentojë të përmbys epërsinë e Realit të Madridit prej 3-1 nga ndeshja e parë. Hendikep për trajnerin e skuadrës parisien Unai Emery do të jetë mungesa e yllit brazilian Neymar, i cili për shkak të lëndimit do të mungojë në këtë përballje. Por, sipas mediave franceze thuhet se Emery ka gjetur zëvendësuesin adekuat të Neymarit dhe ai pritët të jetë argjentinas Di Maria. Di Maria po kalon një moment të mirë dhe këtë e konfirmoi në takimin e fundjavës kundër Trojas, kur PSZH fitoi me 2-0, ndërsa autor i një golit ishte pikërisht Di Maria. Por detyra më e vështirë për sulmuesin argjentinas është të përmbysë shifrat 1-3. Derisa, trajneri Emery shpreson që Di Maria të realizojë edhe në sfidën e radhës. "Të dy, Di Maria dhe Neymar, janë lojtarë të rëndësishëm, me cilësi që bëjnë diferencën në fushë. Di Maria ka përvojë dhe dëshirë për të treguar vlerat, është



shumë kompetitiv dhe të martën ai ka shansin të tregojë se është një kampion", tha trajneri Emery, që në ndeshjen ndaj Trojes la pushim shumë nga titullarët, për t'i pasur gati për ndeshjen e Çampionit. "Dua një ekip në 100 për qind të formës ndaj Realit, ku do të rikthehet edhe Mbappe, që e lashë pushim pas këshillës së mjekëve", deklaroi Emery. Ndryshe, Emery në profilin e tij në "Instagram" ka ardhur me një paralajmërim për "Los Blancos", ndoshta me synimin

për të frikësuar sadopak kundër-shtarin, por kryesisht për t'i dhënë zemër lojtarëve të tij. "Në pjesën më të madhe të ndeshjeve të këtij sezoni kemi treguar se mund t'ia dalim, veçanërisht sepse do të luajmë në Parkun e Princave, që do të na japë një shtysë të madhe. Jemi përgatitur në maksimum për këtë përballje. Do të japim maksimumin pa menduar për të shkuarën apo për të ardhmen, por vetëm për ndeshjen që do të luajmë. Do të luajmë në Parkun e

Princave, në shtëpinë tonë dhe bashkë me tifozët tanë do të bëjmë gjithçka është e mundur për të vazhduar shkrimin e historisë së PSZH", deklaroi Emery.

Në anën tjetër, lajme të mira në prag të sfidës së sotme ka marr edhe trajneri i Realit të Madridit, Zinedin Zidane. Dyshja e rëndësishme e ekipit, mesfushorët Toni Kroos dhe Luka Modriç janë kthyer në stërvitje me skuadrën, ndërsa tani mbetet Zidane të vendosë nëse ata do të jenë të aftë për të

luajtur. Të dy mesfushorët kanë qenë jashtë fushave për tri javë, me Modriç që kishte një tendosje të klasës së parë në kofshën e tij dhe Kroos me një lëndim të gjurit. Sikurse Kroos ashtu edhe Modriç mund të luajnë ndaj PSZH-së, por nuk dihet nëse do të jenë titullar. Pavarësisht fitores 3-1 në Madrid, Zidane pret një ndeshje të komplikuar në "Parc des Princes". Ai u ndal edhe te mungesat, por tha se nuk do të "qahej" nëse ata nuk rikuperohen për takimin e kthimit. "Ne e dimë që ndeshja e kthimit kundër PSZH-së do të jetë shumë e vështirë. Ata duan të kualifikohen për në çerekfinale. Është mirë që ne fituam kundër Getafes para se të shkojmë në Paris. Modriç dhe Kroos nuk janë kthyer në stërvitje, ndoshta të dielën. Por, ata do të vijnë me ne në Paris, kjo është e sigurt. Unë nuk do të ankojem për mungesën e mundshme të tyre, ne kemi lojtarët për të kompensuar mungesat", tha Zidane.

Ndërkohë, përballja tjetër e ditës së sotme mes Liverpoolit dhe Portos do të jetë vetëm formale, pas fitores së thellë prej 5-0 e skuadrës angleze në ndeshjen e parë në Portugal.



## Telefonata Bonuçi-Ranokia, vendimtare për shtyrjen e derbit

Tronditja për vdekjen e Davide Astori është ende një plagë e freskët, që do të marrë kohë për t'u shëruar në Seria A. Pikëllim i madh për të gjithë ata që e njihnin atë. Bashkëlojtarët nuk kanë reshtur së vlerësuar mbrojtësin e pafat dhe kapitenin e Fiorentinës. Këtu përfshihen edhe Leonardo Bonuçi me Andrea Ranokia, të cilët, me Astorin kanë ndarë disa grumbullime me ekipin kombëtar. Një miqësi shumë e fortë për të siguruar që, edhe një garë aq e rëndësishme, sa pritej, si derbi i Milanos, mund të diskutohet. Sipas asaj që shkruan "Il Corriere della Sera", menjëherë pas mesimit të lajmit tragjik, kapiteni kuqezi do të telefononte shokun dhe

kolegun e Interit. Natyrisht, të dy pajtohen që të mos zbresin në fushë të dielën, çka ndodhi para se të arrinte vendimi zyrtar për shtyrjen e të gjitha sfidave të së dielës në Seria A. Në të dyja ekipet janë disa lojtarë, që me Astorin kanë kaluar kohë të ndryshme në karrierën e tyre: Te Milani është Montolivo dhe, veçanërisht Antonelli, me të cilin ai ka luajtur te të rinjtë e kuqezinjve, ndërsa tek Interi është padyshim Veçino dhe Borja Valero, shokë skuadre në të kaluarën me mbrojtësin e ndarë nga jeta dje. Duke luajtur me këtë barrë mbi supë do të ishte bërë një derbi surreal, në një klimë jo të përshtatshme për një ndeshje të tillë.

## KONTE I KUNDËRPËRGJIGJET REDNAPP DHE NEVILL

### Analisti duhet të përdorë trurin kur flet për taktika

Antonio Conte i ka quajtur "budallenj" analistët e "Sky Sports" Xhemi Rednapp dhe Geri Neville pasi ata e përshkruajtën paraqitjen e Çellsit në humbjen 1-0 ndaj Mançester Sinit si të turpshme. "Analisti duhet të përdorë trurin kur flet për taktika. Mendoj se duhet të kesh njohurinë e duhur për të folur rreth taktikave dhe të mos flasësh budallallëq. Duhet të pranosh çdo kritikë por nuk jam budalla të luaj hapur ndaj Mançester Sinit dhe të humbas 3-0 apo 4-0. Arsenali luajti hapur dy herë ndaj tyre dhe ju të

medias e keni kritikuar shumë ArseneVengerin pasi pësuan tre gola brenda 30 minutave. Sot Siti tregoi diferencën me ne. Siti është një skuadër që ka mentalitet dhe kualitet të madh. Thjesht është një skuadër e pandalshme", deklaroi Conte. Kujtojmë, pas përfundimit të ndeshjes Rednapp tha se paraqitja e Çellsit ndaj Mançester Sinit ishte një krim ndaj futbollit. Rednapp ka mbetur i zhgënjyer nga paraqitja e kampionëve në fuqi, të cilët tani janë pesë pikë larg vendit të katërt Totenhem me vetëm nëntë

ndeshje të mbetura. "Ky nuk ishte futboll, ky ishte anti-futboll. Ishte një krim ndaj futbollit. Po prisja me padurim të shikoja këtë ndeshje sot. E kuptoj që të luash pa një qëndërsulmues mund të jetë një strategji e mirë, por duhet të kesh një qëllim. Çellsit ka lojtarë të mirë – u duk sikur nuk donin të dilnin përpara. Siti nuk kishte pse të ishte aq mirë. Çellsit sikur nuk donte të luante fare. Ata duhet t'ia kishin dhënë tri pikët Sinit pa filluar akoma ndeshja", tha Rednapp për "Sky Sports".





**DASHI** 21. mars - 20. prill

Ju duhet të gjeni dialogun me partnerin/en, përpiquini të kërkonini më shpesh praninë e tij/saj. Nëse keni bërë gabime, përgjegjësia nuk është vetëm e juaja. Beqarët do të duhet të shikojnë përreth dhe të bëjnë një përzgjedhje të miqësive të tyre. Mos refuzoni ndihmën e një kolegu në punë, do t'ju duhet për të arritur qëllimet e dëshiruara.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Do të ndiheni të demoralizuar dhe të lënduar, sot dashuria nuk është vërtet mirë. Reflektoni për gabimet tuaja dhe përpiquini të rikuperoni, gjithçka është e mundur! Beqarët do të jenë në gjendje të identifikojnë një person që ka shprehur simpati për ta, por nuk dëshirojnë ta pranojnë. Ka ardhur koha që të përqendrohni në karrierën tuaj, keni të gjitha kredencialet.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Sot ju do të keni për të rregulluar një situatë të komplikuar sentimentale që keni krijuar pa dashur. Rrëfeni sekretet tuaja tek partneri/ja dhe largoni të kaluarën. Me pjesëmarrjen e Merkurit, beqarët mund të takojnë dikë shumë të veçantë. Disa grindje ose shumë diskutime do të ndryshojnë gjendjen tuaj me kolegët. Mos u shqetësoni, çdo gjë do të zhduket shpejt!



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Jini të sinqertë në dashuri dhe mos bëni premtime që nuk mund t'i mbani. Qëndroni në ndonjë keqkuptim të zakonshëm dhe tregoni ndjenjat tuaja të vërteta. Beqarët do të ndihen pak të nënshtruar dhe do të kenë pak dëshirë për të bërë takime apo njohje të reja. Punë e vështirë për të treguar sa jeni të vlefshëm, është koha që të mos lini asnjë gur të palëvizur dhe të shfrytëzoni çdo mundësi.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Sot do të përjetoni momente intensive me personin e zemrës. Dashuria është në krye dhe mund t'i kushtoni gjithë kohën tuaj puthjeve dhe butësisë, do të merrni njëqind herë më shumë lavdërimi! Beqarët që kërkojnë për shpirtin e tyre binjak mund të shprejsojnë të takojnë personin e duhur. Nuk u takon të tjerëve të gjykojnë projektin tuaj, dikush mund të bëjë që ju të largoheni nga smira.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Jeni të bindur se gjithçka është kundër jush. Mos u shqetësoni, kjo është vetëm përshkrim i juaj, duhet të jeni më të lirshëm dhe do të shihni se gjithçka do të duket më e qartë. Sot zemrat e vetmuara do të jenë veçanërisht interesante dhe do të tërheqin shumë persona rreth vete! Ngadalësoni ritmin e punës, jeni shumë të zënë, lini disa përgjegjësi për të tjerët.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Ju jeni shumë të dashuruar dhe do të bëni gjithçka për të ruajtur lumturinë. Tashmë mund të hidhni themelet për një projekt në çift, shikoni se çfarë mendon partneri/ja juaj! Lajme të mira edhe për beqarët që duan të udhëtojnë dhe të argëtohen, do të jetë një ditë e gazuar! Marsi do t'ju ndihmojë të keni më shumë besim tek vetja dhe angazhimi juaj në punë do të jetë i tillë që të vihet re nga eporët!



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Kuptimi në çift do të vendosë krahët në historinë tuaj të dashurisë, duhet ta pranoni se nuk po shkon keq asgjë. Por përpiquini të jeni më të hapur për dialog. Beqarët do të duhet të përpiquen për të mbajtur një premtim, por vështirë se do të kenë sukses. Ndoshta nuk jeni shumë të fokusuar në projektet tuaja dhe ju duket se diçka është e gabuar. Përqendrohuni te qëllimet tuaja.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Do të gesh pak 'ekuilibër në çështjet sentimentale dhe këtë ditë do të shohësh pak më shumë lehtësim. Përkushtojuni pasionit dhe gjithçka do të zgjidhet! Zemrat e vetmuara që kanë vendosur të kthejnë faqen sot do të duan të argëtohen dhe të provojnë përvoja të reja! Ju nuk do t'ju mungojë energjia dhe vendosmëria për tu përbaluar me angazhimet në punë.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Mos e lini veten dhe ndjenjat tuaja në hije dhe të shkoni pas nevojave të partnerit/es tuaj. Mos u anconi për çdo gjë të vogël dhe përpiquini të shmangni tensionet në çift. Beqarët do të kenë njohje të reja, por do të jenë të zënë duke u përpjekur për të bërë për vete një person që ju pëlqen. Do të merrni shumë përgjegjësi në punë dhe me ndihmën e Merkurit do të jeni në gjendje të gjeni një zgjidhje për gjithçka.




**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Bëni disa sakrificë për t'i dhënë përsëri jetë marrëdhënive tuaja. Sot merrni nismën në dashuri dhe jepini freskinë përsëri një historie që duket se është bërë e paqartë. Jepini sugjerime të reja partnerit/es! Beqarët do të jenë në gjendje të marrin një konfirmim nga një i njohur. Do të dëshironi të punoni në një projekt që është afër zemrës suaj, mos prisni më gjatë, por vazhdoni!



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Sot ju mund të keni mundësi të shkëlqyeshme për të zgjidhur një problem dashurie që ju bën të mendoheni. Mos e humbni situatën dhe merrni me gjithçka në kohën e duhur. Beqarët do të jenë në gjendje të kultivojnë shpresën për të gjetur dashurinë, sot ata mund të bëjnë takime vendimtare. Merkuri do t'ju ndihmojë të arrini rezultate të rëndësishme në punë.



KOHA	VEPËR E AUTORIT NË FOTO	DRU PYLLI I LARTË	AMERICIUMI	BELGJIKA	E SHOQJA E AGAT GRUP MUZIKOR AMERIKAN	Mensur Mamuti	VEPËR E AUTORIT KOLUMBIAN NË FOTO SHIH FOTON	NJ	TIMES INTERNET LIMITED	NDIKIM
PËRPUNIMET E DETAJUARA TË NJË PROJEKTI						AUTORI GJERMAN, JOHAN VOLFGANG				
VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE				PALCË		PATRIOTI I SANXHAKUT TË PAZARIT TË RI, BLYTA				
AJNSHTAJNIUMI			PIKTORI HOLANDEZ VAN GOG			AQ ME TEPËR; MADJE				
AZOTI		MINERAL QË PERMBAN ME SHUMË ALUMIN UJË I INGRIRË				RADONI			KALIUMI	
BURRË TRIM E BUJAR				SKAMJA		RISI NË FE			ADACTA	
QË KA NGJYRË TË KUQË				JA		<b>B</b>				
LOJË KAZINOJE					JO I KEQI T.Ç.	AKTORJA JONË ALIKAJ				SHAKA ME VËREJTJE
NGJYRA E KUQË E NDEZUR						LUAN JAHA			BORI	
				FSHAT NË KUANOVË		KOMPOZITORI RUS, ANTON			PËRRUA I MADH QË ZBRET NGAMALET	

ZGJIDHJET: NJ, GËTJE, AQIE, BILE, RN, K, BIDAT, EVA, LJ, B, AGESHA, ELABORATET, RIM, NERV, U, ES, VINSENT, N, BOKSIT, A, DAL, SKAMA, I KUQ, I MIRI, RULET, A, IN, ALLE, ÇERKEZ.

**Sudoku**

shumë i lehtë

mesatar

										1		7	2	9		8
1		2		8		9		6					9		1	
	5		3		6		8					8			6	
		5			3	7			2	7					4	
	2							5	8							3
		6	7			3				3						8
	7		4		1		2			4			5			
8		1		2		6		5		2		3				1
									7	5	9	4				

Shumë i lehtë: 698172543, 132584976, 754396281, 985213764, 327649158, 416758392, 573461829, 841927635, 269835417. Mesatar: 516472938, 382659714, 497813625, 271538496, 849726153, 653194287, 164285379, 928367541, 735941862.

## Valoni, berberi i ish-kryeministrit britanik, Cameron



Ai është nga Prishtina. Emrin e ka Valon Sadiku, dhe punon prej vitesh si berber në Londër. Lokali ku ai punon ndodhet në tregun Borough në kryeqytetin britanik. Shumë turistë dhe fytyra publike janë klientë të tij. Sigurisht më i njohuri ishte, ish-kryeministri i Britanisë së Madhe David Cameron. Cameron, flokët e tij ia kishite besuar pikërisht Valonit. Në fund, dyshja kanë realizuar disa fotografi dhe të dy palët shfaqen të kënaqura. Cameron ishte kryeministër i Britanisë së Madhe nga viti 2010 deri më 2016.



## Sa më të pasur të jemi, aq më pak kënaqësi ndjejmë

E dëshmon një sondazh i kryer pesë vjet më parë nga Zhordi Kuidbah nga Universiteti i Liezhit në Belgjikë me 350 meshkuj të rritur, me prejardhje të ndryshme sociale. Të pyeturit treguan se mesatarisht ata që janë më të pasur, kanë një reagim më të vogël ndaj gëzimeve të vogla të jetës së përditshme. Për më tepër, që në vitet '80 Xhordan Grafman nga Instituti i Rehabilitimit në Çikago (SHBA), kishte dëshmuar se ata që dhuronin paratë e tyre përfitonin kënaqësi. Pasi rekrutoi disa individë, të cilëve iu dha një listë me shoqata vullnetare dhe një sasi e përcaktuar parash, ai u kërkoi atyre të zgjidhnin një nga tre alternativat: t'i dhuronin paratë për një organizatë, të refuzonin ta bënin këtë, apo të depozitonin një pjesë të parave në llogarinë e tyre personale. Ata që zgjodhën të dhurojnë sasinë e parave një organizate, kishin aktivizuar një zonë të veçantë të trurit, e lidhur me funksionin e seksit apo të të ngrënit. Kjo tregon se është altruizmi, më shumë sesa egoizmi, ai që prodhon më shumë ndjesi kënaqësie.

## Çfarë duhet të dini nëse keni më shumë se 150 shokë në Facebook



Përdorimi i rrjeteve sociale po rritet ndjeshëm ditë e sotme, ndërsa shumë persona kanë mani për të rritur edhe numrin e miqve. Por, sipas një studimi është thuar se pamundur të keni më shumë se 150 miq aktivë në rrjetin social të krijuar nga Zuckerberg. Kjo është konfirmuar nga një studim i publikuar në "Social Networks", i cili ka analizuar të dhënat e mbi 130 mijë profileve aktive në 'Facebook', duke zbuluar se për interaktivitet online, përdoruesit shpesh përdorin një lloj strukture sociale të përbërë nga disa shtresa ose qarqe, të cilat korrespondojnë me nivele të ndryshme të miqësisë. Sipas

këtij kërkimi vihet re se nivelet e miqësisë janë të përbërë nga 5, 15, 50 apo 150 miq secili, të klasifikuara në bazë të sasisë dhe shpeshtisë së kontakteve që personat kanë me çdo mik. 5 janë miqtë që më të ngushtë, pra ata më të mirët, sasia e të folurit me të cilët është në nivele të kënaqshme. Pra, të kesh mbi 150 miqësi të vërteta duket si diçka e pavërtetë dhe që nuk mund të realizohet kurrë. Kjo strukturë është zbuluar nëpërmjet një serie të të dhënave të marra nga rrjetet sociale 'Facebook' e 'Twitter', të kombinuara me strukturat që përbëjnë marrëdhëniet tradicionale shoqërore, pra, me ato në jetën reale.

## Operacion në tru pacientit të gabuar, pezullohet i gjithë stafi



Një staf i tërë mjekësor deri tek drejtuesi i spitalit është pezulluar nga puna në Nairobi të Kenias, pasi operuan në tru pacientin e gabuar. Sipas asaj që shkruan BBC, një pacient duhet t'i nënshtrohej ndërhyrjes për pasi kishte pësuar mpiksje gjaku në tru, ndërsa tjetri duhej t'i nënshtrohej një trajtimi për ënjtje. Por një ngatërrim i etiketave identifikuese të pacientëve, çoi në operimin e personit të gabuar. Mjekët e kuptuan gabimin e rëndë vetëm disa orë pasi ndodheshin në sallë të operacionit, kur sigurisht nuk arritën të gjenin mpiksjen e gjakut. Pacienti në fjalë ndodhet i shtruar në spital, nën kujdes mjekësor, ndërsa për rastin ka nisur një hetim. Ndërkohë, në rrjetet sociale janë të shumtë ata që janë shprehur të tronditur nga kjo ngjarje.

1728 - Spanja dhe Anglia nënshkruajnë Marrëveshjen e Parë të Pardos.

1799 - Napoleoni pushton Jaffa në Palestinë.

1816 - Hebrrenjtë dëbohen nga qyteti i lirë i Lubekut, Gjermani.

1831 - Edgar Allen Poe largohet nga Akademia ushtarake në West Point

1869 - Dmitri Mendeleev prezanton tabelën e parë periodike para Shoqatës së kimistëve të Rusisë.

1882 - Monarku Millan Obrenovic i Serbisë kurorëzon veten mbret.

1915 - Mbreti grek Konstantini I shkarkon kryeministrin Venizellos

1967 - Vajza e Stalinit, Svetlana Alilujeva kërkon azil politik në SHBA

1988 - Tre të dyshuar të IRA janë vrarë në Gjibraltar nga oficerë të SAS.

1992 - Themelohet Këshilli i Shteteve të Detit Baltik.

KALENDARI HISTORIK 6 MARS



A E DINI SE...

Parakalimi në Tapetin e Kuq, është edhe emblema e Çmimeve Oscars, që këtë vit zhvillon edicionin e 90 të tij. Totali i buxhetit për organizimin e ceremonisë, është rreth

42 milionë dollarë, ndërsa Tapeti i Kuq, i gjatë rreth 150 metra, kushton rreth 360 mijë dollarë. Gjithashtu, vlen të përmendet se Dolby Theatre, në Hollywood, paguan rreth 2 milionë dollarë, për të pritur Çmimet Oscars. Edhe statuja Oscar, që jepet për fituesit, peshon disi më pak se 4 kg, ndërsa kushton rreth 500 mijë dollarë.



### MËSUESJA DHE TINI

Sa bëjnë 5 + 5 të keqen mësuesja? Tini i numëron me gishta: 10 mësuese.

Mësuesja e pa dhe i thotë: Tini, futi duart ne xhepa dhe tani më thuj sa bëjnë 5+5?

Tini: Tani më dalin 11!

### PARET NËNSQETULL

Pse biondet i fusin paratë nënsqetull?

Për të thënë që i kanë fituar me djers!

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Prindërit dinë diçka që ti nuk e di. Ndoshta, para se të lindje ti, prindërit e tu nuk kanë qenë aq të mërzitshëm sa janë sot.

(Bill Gates)